

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligji “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	I brendshëm/ transpozim i BE-së/ ndërkombëtar
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	- Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian; - Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, - Konventa e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, - Konventa nr. 190 “Mbi dhunën dhe ngacmimin në botën e punës” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës; - Direktiva (BE) 2024/1385 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 maj 2024 “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”. - Akte të tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Projektligji është përafuar tërësisht me: - Direktivën (BE) 2024/1385 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 maj 2024 “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, për sa i përket parashikimeve civile-administrative që i përkasin këtij Projektligji, ndërsa për parashikime të tjera të natyrës penale do të duhet të bëhet përafrimi në dispozitat e Kodit Penal.
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	-Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 88, datë 22.2.2023 “Për miratimin e strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030” -Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 400, datë 30.6.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore 2021-2030” - Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 736, datë 13.12.2023 "Për miratimin e Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës” - Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 11.1.2024 “Për miratimin e planit kombëtar për integrimin evropian 2024–2026” - Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 10.10.2024 Për miratimin e dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024–2027”, në kuadër të instrumentit të Bashkimit Evropian

	“Faciliteti për reforma dhe rritje për Ballkanin Perëndimor” - Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 e Bashkimit Evropian, e specifikuar më tej në Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025, publikuar në 25 nëntor 2020; - Marrëveshja e Stabilizim Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre anëtare (MSA).
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	06.10.2025 deri në 03.11.2025
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT?	Po,
NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	22/10/2025
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	2025 – MSHMS – Nr. 3
TË DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Xhenson Cela Xhenson.cela@shendetesia.gov.al

PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)

PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT

Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)

Problemi në Shqyrtim:

Dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje janë çështje të thella dhe shqetësuese që prekin shoqërinë shqiptare. Sipas statistikave, rreth 50% e grave në Shqipëri raportojnë se kanë përjetuar ndonjë formë dhune gjatë jetës së tyre, përfshirë dhunën fizike, psikologjike, dhe emocionale. Kjo situatë është e komplikuar nga stigma sociale dhe frika nga hakmarrja, e cila shpesh pengon viktimat të denoncojnë rastet e dhunës. Ligji aktual, nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, është i vjetëruar dhe nuk përfshin të gjitha format e dhunës, veçanërisht ato që ndodhin në sferën publike ose në mjediset e lehtësuara nga teknologjia. Kjo ka rezultuar në një mjedis të pasigurt për gratë, ku shumë prej tyre ndihen të pambrojtura dhe të paafta për të kërkuar ndihmë.

Shkaqet e Problemit:

Shkaqet e këtij problemi janë të shumta dhe të ndërlydhura. Një nga arsyet kryesore është mungesa e harmonizimit të legjislacionit shqiptar me standardet e Bashkimit Evropian dhe rekomandimet ndërkombëtare, si CEDAË dhe GREVIO. Ligji aktual nuk adreson format e reja të dhunës, si dhuna e lehtësuar nga teknologjia, ngacmimi seksual në vendin e punës, dhe dhuna në procese zgjedhore dhe në politikë. Aktualisht me Ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (Ndryshuar me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020), është rregulluar dhuna në marrëdhëniet familjare por nuk janë parashikuar forma të tjera të dhunës ndaj grave, si në sferën private ashtu edhe në atë publike. Ligji aktual rregullon çështjet themelore të dhunës në familje si dhe masat e mbrojtjes ndaj saj, por kjo nuk është e mjaftueshme për mbrojtjen nga të gjitha format e dhunës ndaj grave. Që kur ka hyrë në fuqi, ky ligj është ndryshuar dhe amenduar katër herë, për të garantuar mbrojtjen e duhur ndaj kësaj forme dhune, por nga një sërë vlerësimesh

të organizmave të brendshëm dhe ndërkombëtarë, është vënë në pah nevoja për ndryshime ligjore me qëllim arritjen e mbrojtjes gjithëpërfshirëse nga të gjitha format e dhunës.

Forma të tjera të dhunës ndaj grave, ndonëse të parashikuara si vepra penale, nuk kanë marrë vëmendjen e duhur në lidhje me parandalimin dhe masat e mbrojtjes civile/administrative, pavarësisht nevojës për adresimin e tyre. Mjetet ligjore në fuqi, nuk janë të mjaftueshme me qëllim që autoritetet përgjegjëse të përmbushin detyrimet për të marrë masa të nevojshme parandaluese ose mbrojtëse brenda objektit të kompetencave të tyre. Në dhënien e shërbimeve emergjente dhe atyre afat-mesme dhe afat-gjata, për viktimat e dhunës ndaj grave, duhet të ketë një reagim të duhur në plotësimin e boshllëqeve legjislativë dhe atyre institucionale, për t'iu përgjigjur nevojave të të mbijetuarave të dhunës në përputhje me standardet ndërkombëtare, e konkretisht plotësimit të legjislacionit duke përfshirë dhunën dhe ngacmimin seksual, ngacmimin në mjedisin e punës, dhunën e lehtësuar nga teknologjia etj.

Mungesa e një kuadri ligjor gjithëpërfshirës krijon boshllëqe në mbrojtjen e viktimave dhe pengon qasjen në shërbime të nevojshme për mbështetje dhe rehabilitim. Përveç kësaj, normat kulturore dhe tradicionale, të cilat shpesh e minimizojnë rëndësinë e dhunës ndaj grave, kontribuojnë në vazhdimin e ciklit të dhunës. Edukimi i pamjaftueshëm mbi të drejtat e grave dhe mungesa e ndërgjegjësimit të shoqërisë për pasojat e dhunës ndaj grave janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm që kontribuojnë në këtë problem.

Shtrirja e Problem:

Shtrirja e problemit është e gjerë dhe ndikon në shumë aspekte të jetës sociale dhe ekonomike. Dhuna ndaj grave prek jo vetëm individë, por gjithashtu komunitete dhe shoqërinë në tërësi. Rreth 50% e grave që përjetojnë dhunë, shumë prej të cilave janë në situata të varfërisë, nuk kanë akses në shërbime të nevojshme mbështetjeje. Kjo situatë nënkupton se shumë gra dhe vajza, përfshirë ato nga grupe të cënueshme, janë të rrezikuara dhe nuk mund të gjejnë mbështetje adekuate. Ndikimi i dhunës është gjithashtu i dukshëm në fëmijët, të cilët përjetojnë trauma emocionale dhe psikologjike si pasojë e dhunës që ndodhet në ambientin e tyre familjar.

Grupet e prekura nga ky problem përfshijnë: Gratë dhe vajzat si viktimat kryesore të dhunës, të cilat përballen me pasojat fizike dhe psikologjike; Fëmijët si dëshmitarë të dhunës, që përjetojnë trauma që ndikojnë në zhvillimin e tyre; Burrat si autorë të dhunës por edhe viktima, ata gjithashtu preken nga pasojat sociale dhe ligjore; Institucionet publike si Qeveria dhe autoritetet lokale që kanë detyrime për të mbrojtur viktimat dhe për të parandaluar dhunën; Shoqëria Civile nëpërmjet organizatave që ofrojnë mbështetje dhe shërbime për viktimat, të cilat janë të rëndësishme në procesin e rehabilitimit.

Nevoja për ndërhyrjen e Qeverisë:

Qeveria ka një detyrim të fortë për të ndërhyrë në këtë situatë për disa arsye. Së pari, dhuna ndaj grave është një shkelje e drejtëpërdrejtë e të drejtave të njeriut dhe kërkon një qasje të integruar dhe efektive për të garantuar mbrojtjen e viktimave. Së dyti, Shqipëria ka angazhime ndërkombëtare për të përmbushur standardet e mbrojtjes nga dhuna dhe diskriminimi, siç janë ato të konventave të BE-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare. Së fundmi, ndërhyrja e qeverisë është e domosdoshme për të përmirësuar situatën sociale dhe për të ndihmuar në krijimin e një shoqërie më të drejtë dhe të barabartë, ku gratë dhe vajzat ndihen të sigurta dhe të mbrojtura.

Parandalimi, eliminimi dhe mbrojtja nga të gjitha format e dhunës ndaj grave në veprimtarinë publike dhe private dhe dhunës në familje, është një ndër prioritetet dhe drejtimet kryesore politike për zhvillimin e vendit. Në kuadër të çeljes së negociatave me Bashkimin Evropian dhe nevojës për përafrimin sa më të plotë të legjislacionit shqiptar me aktet e mësipërme të BE-së, është e nevojshme të bëhen rregullimet e duhura ligjore që mundësojnë arritjen de facto të parandalimit, eliminimit, mbrojtjes nga të gjitha format të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në shoqërinë shqiptare, si kusht drejt një zhvillimi të qëndrueshëm.

Prandaj, është e nevojshme që qeveria të miratojë një ligj të ri për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, i cili do të adresojë këto çështje dhe do të sigurojë mbrojtje efektive për të gjitha viktimat. Ky ligj do të ndihmojë në krijimin e një ambienti më të sigurt dhe më të qëndrueshëm për gratë dhe vajzat në Shqipëri, duke kontribuar kështu në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

1 Politika që synohet të zhvillohet përmes kësaj ndërhyrje ligjore ka disa objektiva strategjike:

1. Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare mbi luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, dhe të drejtat e njeriut brenda vitit 2026. (të përcaktohet nga drejtoria)
2. Forcimi i mekanizmave dhe instrumentave për zbatimin e mbrojtjes nga dhuna në marrëdhëniet familjare dhe më gjerë brenda vitit .(te përcaktohet afat nga MSHMS)
3. Fuqizimi i rolit të grupeve të interesit nga shoqëria civile për të marrë pjesë në ofrimin e shërbimeve për shmangien e dhunës në familje, në vendin e punës, etj dhe korrigjimin e pasojave të vijnë prej saj.
4. Garantimi i mbrojtjes nga dhuna e mosdiskriminimi, nga ngacmimi dhe ngacmimi seksual, si në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat. Integrimi i buxhetimit gjinor në të gjitha politikat publike dhe proceset vendimmarrëse qeveritare, duke garantuar mbështetje të dedikuara financiare për qendrat dhe organizatat e shoqërisë civile që kontribuojnë në parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe dhuna në familje.
5. Krijimi i mekanizmave të posaçëm për përpunimin e të dhënave dhe krijimin e instrumenteve të matjes dhe monitorimit, me qëllim vlerësimin e gjendjes aktuale të grave dhe vajzave të përfshira në raste dhune dhe ngacmimi, si bazë për politika të efektshme parandaluese dhe mbrojtëse.
6. *Zgjerimi i mbrojtjes përtej sferës familjare, duke përfshirë mjedisin publik, privat dhe digjital’*
7. *Garantimi i aksesit falas, të shpejtë dhe të thjeshtuar për viktimat në gjykata dhe mekanizma të tjerë administrativë.*
Krijimi dhe funksionalizimi i rrjetit të koordinuar të referimit në nivel qendror dhe vendor.
8. *Qartësimi i roleve dhe detyrimeve të autoriteteve publike dhe subjekteve private.*
9. *Forcimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe institucionet e të drejtave të njeriut.*
10. *Sigurimi i shërbimeve 24/7, strehimit emergjent, ndihmës psikosociale, juridike dhe ekonomike.*
11. *Krijimi i standardeve të unifikuara të shërbimeve dhe rritja e kapaciteteve të punonjësve.*
12. *Rehabilitimi dhe riintegrimi i viktimave dhe sipas rastit, programe të detyrueshme për autorët.*

Objektivat e mëposhtëm specifikë përfaqësojnë drejtimet kryesore të ndikimit që pritet të gjenerojë nisma e propozuar:

1. Harmonizimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor, me ligjin për barazinë gjinore dhe direktivat përkatëse të BE-së deri në vitin 2030.
2. Integrimi i të dhënave të analizës së situatës aktuale dhe perspektivave të dhunës ndaj grave në të gjitha politikat sektoriale përkatëse, duke zhvilluar raporte vjetore dhe rekomandime konkrete, deri në vitin 2028.
3. Institucionalizimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të paktën 10 institucione publike (ministri, struktura vartëse dhe bashki) me qëllim forcimin e mekanizmave mbrojtës dhe rritjen e funksionimit të qendrave të mbrojtjes nga dhuna, deri në vitin 2030.

4. Sigurimi i mbështetjes financiare për të paktën 1500 gra dhe vajza të dhunuara deri në vitin 2030, duke përfshirë akses në skema punësimi dhe strehim social sipas nevojave individuale.
5. Miratimi i politikave për rritjen e ekuilibrit punë-jetë, në të gjitha institucionet publike dhe sektoret kryesore, duke përfshirë masa fleksibile dhe mekanizma mbrojtës, deri në vitin 2027, me qëllim zbutjen e pasojave të dhunës në familje dhe ngacmimit në vendin e punës.
6. Organizimi i një fushate kombëtare vjetore për ndërgjegjësimin mbi format e dhunës dhe të drejtat e grave në familje, në ambjentin e punës, me qëllim referimin e rasteve të dhunës dhe adresimin e zgjidhjes së pasojave jo vetëm në qytete, por edhe në zonat rurale dhe komunitetet e marginalizuara, duke mbuluar të paktën 61 bashki deri në vitin 2030, me matjen e rezultateve përmes numrit të pjesëmarrësve dhe rasteve të referuara për adresim.
7. Përfshirja e moduleve mbi mbrojtjen nga dhuna, diskriminimi dhe të drejtat e njeriut në kurrikulat në të gjitha kurrikulat parauniversitare dhe universitare, duke synuar të paktën X% e shkollave dhe universiteteve deri në vitin 2027.
8. Funksionalizimi i mekanizmave të integruar për mbledhjen, analizimin dhe publikimin e të dhënave të ndara mbi rastet e dhunës në familje dhe më gjerë, duke përmirësuar sistemin e monitorimit dhe raportimit, deri në vitin 2026.

OPSIONET E POLITIKAVE

Cilat janë opsionet kryesore të politikave? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të dizavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. (jo më shumë se 7 rreshta)

Për të adresuar problemin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, janë shqyrtuar disa opsione politike. Çdo opsion ka avantazhet dhe disavantazhet e tij, të cilat janë përmbledhur si më poshtë:

1. Opsioni 1: Ruajtja e Status-quo-së

Avantazhet: Nuk kërkon ndryshime ligjore, duke shmangur proceset burokratike dhe kostot e mundshme të implementimit; Lejon vazhdimin e përdorimit të strukturave ekzistuese.

Disavantazhet: Nuk adreson problemet aktuale dhe boshllëqet ligjore, duke vazhduar të lërë viktimat të pambrojtura; Rrezikon të përkeqësojë situatën e dhunës ndaj grave dhe të pengojë përparimin në drejtim të barazisë gjinore.

2. Opsioni 2: Ndërhyrje të targetuara në aktet ligjore sektoriale

Avantazhet: Mund të sjellë përmirësime të menjëhershme në disa aspekte të legjislacionit ekzistues; Kosto më të ulëta për ndryshime të pjesshme.

Disavantazhet: Mbetet një kuadër ligjor i fragmentuar, që mund të vështirësojë zbatimin dhe monitorimin; Nuk ofron një zgjidhje të plotë për problemet e dhunës ndaj grave.

3. Opsioni 3: Bërja e ndryshimeve në ligjin ekzistues

Avantazhet: Mund të adresojë disa çështje të rëndësishme dhe të përmirësojë mbrojtjen e viktimave; Merr më pak kosto dhe kohë se sa hartimi i një ligji të ri.

Disavantazhet: Mund të mbetet i kufizuar në përmirësimin e disa aspekteve, pa garantuar një qasje të plotë; Rrezikon të krijojë konfuzion në zbatim për shkak të mbivendosjes me ligje të tjera.

4. Opsioni 4: Hartimi i një ligji të ri

Avantazhet: Siguron një qasje gjithëpërfshirëse dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare; Krijon një kuadër të qartë dhe të unifikuar për mbrojtjen nga dhuna dhe diskriminimi.

Disavantazhet: Kosto fillestare më të larta për qeverinë për hartimin dhe implementimin e ligjit të ri; Mund të kërkojë një angazhim të fortë politik dhe administrativ për zbatimin e tij.

5. Opsioni 5: Jo-Rregullator

Avantazhet: Mund të ofrojnë një zgjidhje të shpejtë dhe me kosto të ulët për problemet e evidentuara; Rrit ndjeshmërinë për çështjet e dhunës dhe promovon ndërgjegjësimin publik.

Disavantazhet: Nuk ofron një kuadër ligjor të detyrueshëm dhe mund të ketë ndikim të kufizuar; Rrezikon të mbetet në nivelin e deklaratave pa ndonjë zbatim efektiv.

Përfundim:

Pas shqyrtimit të opsioneve të politikave, **Opsioni 4 (Hartimi i një ligji të ri) Rregullator** duket të jetë zgjidhja më e mirë për të adresuar problemet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Ky opsion ofron një qasje gjithëpërfshirëse, duke siguruar që legjislacioni të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të adresojë të gjitha format e dhunës. Megjithatë, do të kërkojë një angazhim të fortë nga qeveria dhe burime të mjaftueshme për zbatimin e tij efektiv.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasiore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (Jo më shumë se 10 rreshta)

Opsioni i preferuar është opsioni numër 4 i cili mundëson hartimin e një kuadri rregullator të ri duke adresuar në mënyrë gjithëpërfshirëse nevojat dhe problematikat ekzistuese dhe respekton standardet kombëtare e ndërkombëtare.

NDIKIMET E OPSIONIT TË PREFERUAR

Kjo rubrikë përmbledh ndikimet sociale dhe ekonomike të rregullimeve të propozuara, duke identifikuar grupet kryesore të prekura dhe pasojat që mund të kenë ndryshimet ligjore dhe politike mbi ta. Analiza tregon përfitimet e mundshme dhe sfidat e secilit grup dhe pasojat për buxhetin e shtetit.

Grupet kryesore të prekura përfshijnë:

1. **Gratë dhe vajzat:** Përfitojnë nga mbrojtja më e mirë ligjore dhe politikat e parandalimit, mbështetjes, mbrojtjes dhe rehabilitimit nga të gjitha format e dhunës. Grupet e prekura brenda kësaj kategorie përfshijnë: Gratë dhe vajzat viktimë të dhunës fizike; Gratë dhe vajzat viktimë të dhunës psikologjike; Gratë dhe vajzat viktimë të dhunës dhe ngacmimit seksual; Gratë dhe vajzat viktimë të dhunës së lehtësuar nga teknologjia; Gratë dhe vajzat në politikë.
2. **Fëmijët:** Për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, garantohen masa të përshtatshme dhe të posaçme mbrojtjeje, duke marrë parasysh interesin më të mirë të fëmijës;
3. **Burrat dhe djemtë:** Ndikohen nga masat për promovimin e rolit të tyre kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe eliminimin e stereotipeve gjinore.
4. **Autoritetet publike (qendrore dhe vendore):** Administrata publike dhe institucionet shtetërore, përfshirë institucionet ligjzbatuese dhe gjyqësorin: Angazhohen në zbatimin dhe monitorimin e ligjit.
5. **Punëdhënësit dhe punëmarrësit (sektor publik dhe privat):** Detyrohen të zbatojnë masa për parandalimin e dhunës dhe mbështetjen e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, rritet përgjegjësia e punëdhënësit për të parandaluar dhe adresuar ngacmimin seksual/psikologjik në punë; parashikohen rregulla më të qarta për trajtimin formal dhe joformal të ankesave; përmirësohet kultura e punës dhe siguria në vendin e punës.
6. **Shoqëria civile dhe organizatat për të drejtat e grave:** Përfitojnë nga një kuadër më i fortë ligjor për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje; mundësi rritjeje të financimeve publike dhe ndërkombëtare dhe rritje e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve.

Ky ligj përfshin një qasje gjithëpërfshirëse, duke synuar të ketë ndikim në të gjitha fushat e zhvillimit shoqëror dhe ekonomik, duke synuar parandalimin dhe reduktimin e dhunës ndaj grave si në sektorin publik ashtu edhe privat. Konkretisht projektligji i propozuar synon të ketë këto ndikime:

- **Ndikimi financiar:** Llogaritja e efektit financiar bazohet në analizën për kostimin e projektligjit “**Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje**”. Efekti i përgjithshëm financiar është vlerësuar **2 014.1 milion lekë** i shpërndarë në dhjetë vite ose sa 7.3% e PBB së parashikuar për vitin 2026. Shumat sipas viteve në milionë lekë janë: (2026 -148.7 milionë; 2027 - 222.7 milionë; 2028 - 322.7 milionë, 2029 - 160 milionë, 2030 - 260 milionë, 2031 - 160 milionë, 2032- 160 milionë, 2033 – 160 milionë, 2034 - 160 milionë dhe 2035 - 260 milionë). Pjesa tjetër e shpenzimeve mbulohet nga tavanet buxhetore të miratuara të autoriteteve përgjegjëse.
- **Ndikimi ligjor/cilësor:** Projektligji i propozuar harmonizon legjislacionin kombëtar me direktivat e BE-së dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Përmirëson kornizën ligjore dhe ndihmon në implementimin e masave mbrojtëse, sanksioneve civile dhe administrative për rastet e dhunës ndaj grave. Siguron mbrojtje të menjëhershme ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, përmes mjeteve ligjore, civile dhe administrative, masave të tjera të nevojshme dhe politikave të integruara dhe gjithëpërfshirëse, me në qendër viktimën, duke i kushtuar vëmendje të veçantë grupeve të cënueshme. Në varësi të subjekteve të mbrojtura sipas këtij ligji dhe formës së dhunës së ushtruar, urdhrat e mbrojtjes që lëshohen nga organet përgjegjëse, janë specifikuar konkretisht: për masat e mbrojtjes ndaj dhunës në familje; për masat e mbrojtjes nga dhuna e lehtësuar nga teknologjia; për masat mbrojtëse ndaj dhunës ndaj grave në procese zgjedhore dhe në politikë për masat mbrojtëse ndaj dhunës dhe ngacmimit seksual. Parimi i ndalimit të ndërmjetësimit në çështjet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje synon ndalimin e ndërmjetësimit apo pajtimit me detyrim, për rastet që përfshijnë dhunë ndaj grave, përfshirë dhunën në familje. Garantohe mbrojtje nga diskriminimi dhe dhuna, përmes forcimit të mekanizmave ligjorë dhe masave kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.
- **Ndikimi institucional:** Projektligji përmirëson strukturat dhe mekanizmat ekzistues për monitorimin dhe raportimin e dhunës në marrëdhëniet familjare, duke i zgjeruar përgjegjësitë edhe ndaj dhunës ndaj grave. Fuqizon institucionet e drejtësisë, gjyqësorin, institucionet qendrore dhe lokale për të garantuar zbatimin efektiv të politikave kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe krijon mekanizma mbështetës e mbrojtës më efikas. Gjithashtu, përmirëson koordinimin ndërinstitutional dhe përcakton qartë përgjegjësitë e secilit institucion. Parimi i aksesit në drejtësi dhe shërbime përfshin të drejtën e aksesit në drejtësi dhe përfitimit të shërbimeve falas, të aksesueshme lehtësisht pavarësisht nga vendndodhja dhe pengesat, shërbimeve të shpejta, në gjuhë të qartë e të kuptueshme të përshtatura sipas nevojave të posaçme për personat me aftësi të kufizuara, përfshirë strehim emergjent 24/7 dhe ndihmë psiko-sociale.
- **Ndikimi mbi qeverinë:** Ky projektligj përmbush detyrimet e Shqipërisë në kuadër të integritetit evropian dhe angazhimeve ndërkombëtare për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Ai siguron përafrimin e legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së dhe ndërkombëtare dhe rekomandimet e organizmave ndërkombëtarë si CEDAË, Konventa nr.190 e ONP-së, strukturave të GREVIO dhe Komisioni Evropian. Zbatimi i këtij ligji do të përmirësojë progresin e Shqipërisë në fushën e të drejtave të njeriut dhe do të rrisë imazhin e saj në arenën ndërkombëtare. Gjithashtu, ai do të mundësojë një monitorim më të qartë të përmbushjes së detyrimeve të vendit në kuadër të raporteve të progresit të BE-së dhe mekanizmave të mbikëqyrjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.
- **Ndikimi mbi grupet e tjera të prekura:** Ky projektligj do të ndikojë drejtpërdrejt gratë, burrat, grupet e cënueshme, subjektet e mbrojtura nga dhuna në familje, personat e varur, shtetas shqiptarë me vendbanim ose vendqëndrim në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të huajt ose personat pa shtetësi të cilët hyjnë në Republikën e Shqipërisë, të huajt ose personat pa shtetësi që kanë kërkuar mbrojtje ndërkombëtare, sipas legjislacionit në fuqi për azilin në Republikën e Shqipërisë. Të gjitha viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje kanë të drejtë për mbështetje me shërbime të përgjithshme dhe të specializuara. Projektligji do të ketë një ndikim pozitiv në organizatat e shoqërisë civile, të cilat do të kenë një bazë më të fortë ligjore për misionin e tyre në mbështetje të viktimave kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Po ashtu, do të ndikojë tek punëdhënësit dhe institucionet publike për të përmirësuar praktikën e tyre në

zbatimin e Kodit të Punës përsa i përket dhunës dhe ngacmimit seksual në mjedisin e punës, në mjedisin digjital dhe në atë politik. Përmirësohet roli i grave dhe vajzave në familje, i qasjes jodiskriminuese dhe jo ngacmuese në marrëdhëniet e punës.

- **Ndikimi kulturor dhe edukativ:** Projektligji ndikon në eliminimin e stereotipeve gjinore duke promovuar marrjen e masave parandaluese ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si në sferën private ashtu edhe në atë publike. Në të njëjtën kohë, projektligji synon të nxisë aktivitete për ndërgjegjësimin dhe edukimin publik, duke përfshirë angazhimin e burrave dhe djemve si aleatë dhe agentë ndryshimi në parandalimin, çrënjosjen e paragjykimeve, zakoneve, traditave dhe të gjitha praktikave të tjera diskriminuese ndaj grave ose në rolet e stereotipizuara për burrat dhe gratë; aktivitete edukative për fëmijët dhe të rinjtë përfshirë ato mbi rreziqet e dhunës online dhe cenimin e privatësisë nga përmbajtjet e dëmshme në platformat digjitale; publikime, broshura, video, për edukimin publik, në gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme si dhe në formate të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara; fushata ndërgjegjësimi për punëdhënësit, punëmarrësit dhe personat me funksione mbikëqyrëse në sektorin publik dhe privat, për parandalimin dhe trajtimin e ngacmimit seksual në vendin e punës, etj.
- **Ndikimi mbi sektorin privat:** Ky projektligj qartëson dhe thekson pjesëmarrjen e sektorit privat, sektorin e teknologjisë së komunikimit dhe informacionit, medias dhe partive politike, në lidhje me lirinë e shprehjes dhe pavarësinë e tyre, për të marrë pjesë në zbatimin e politikave dhe për të caktuar udhëzime dhe standarde vetërregullatore për parandalimin e dhunës ndaj grave. Autoritetet përgjegjëse sipas këtij ligji bashkëpunojnë me aktorët e sektorit privat, institucionet për mbrojtjen e fëmijëve, për mënyrën si të trajtojnë mjedisin e informacionit dhe komunikimit që ofron akses ndaj përmbajtjes së dëmshme dhe degraduese. Ai synon të vendosë masa të detyrueshme për ndërmarrjet publike dhe private për të marrë masa ndaj dhunës dhe ngacmimit në mjedisin e punës.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsyet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (Jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni 4: Hartimi i ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje

Opsioni i hartimit të një ligji të ri është zgjedhur për shkak të nevojës për një kuadër të përditësuar që siguron parandalimin, eliminimin dhe mbrojtjen nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në veprimtarinë publike, private, përfshirë dhunën në mjedisin e lehtësuar nga teknologjia si dhe në mjedisin e punës apo në zgjedhje dhe në politikë. Ligji aktual nuk adreson në mënyrë të plotë të gjitha llojet dhe format e dhunës, në harmonime legjislacione të BE-së dhe direktivat ndërkombëtare si CEDAË, GREVIO dhe Raportet e Progresit të Komisionit Evropian dhe në të njëjtën kohë nuk reflekton ndryshimet që kanë ndodhur në ligjet e tjera sektoriale në nivel kombëtar.

Ky opsion siguron:

1. Mbrojtje gjithpërfshirëse e pjesëtarëve të familjes dhe mbrojtja e grave nga të gjitha format e dhunës. Një nga sfidat kryesore të ligjit aktual është që ai siguronte mbrojtje vetëm për pjesëtarët e familjes duke u fokusuar vetëm në marrëdhëniet familjare dhe lënë jashtë gratë e dhunuara jashtë jetës dhe marrëdhënieve familjare. Kështu që ligji i ri mban në konsideratë parandalimin, eliminimin dhe mbrojtjen nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në veprimtarinë publike, private, përfshirë dhunën në mjedisin digjital.

2. Përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Opsioni i preferuar synon harmonizimin e kuadrit ligjor kombëtar me direktivat e BE-së dhe konventat ndërkombëtare. Kjo përputhje është thelbësore për procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Shqipëria ka detyrime për të përmirësuar parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE dhe për të përmbushur standarde të larta ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut në situata të dhunës kudoqoftë kjo pavarësisht

mjedisit. Në këtë aspekt, projektligji i propozuar do të përfshijë rregulla të qarta për zbatimin e masave mbrojtëse nga çdo formë e dhunës kundër grave.

3. Forcimi i institucioneve përgjegjëse për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Projektligji synon krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor duke nënvizuar edhe rolin e organizatave të shoqërisë civile, medias dhe sektorit privat, me qasje të integruar duke patur në qendër viktimën si dhe forcimin e sistemit gjyqësor për marrjen e masave të menjëhershme të mbrojtjes ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Gjithashtu për viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje garantohej aksesin dhe shpejtë, falas dhe i thjeshtuar në mjetet juridike pranë gjykatave ose organeve të tjera përgjegjëse. Projektligji synon fuqizimin e mekanizmit duke u ndalur në rolin e autoritetit kryesor përgjegjës (Ministria që mbulon çështjet e barazisë gjinore dhe çështjet sociale), autoritetet përgjegjëse të linjës ku përfshihen të gjitha ministrat dhe institucionet e tjera të administratës publike në nivel qendror dhe institucionet e tyre të varësisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe strukturat e tjera të përfshira në MKR. Subjekte me rëndësi në zbatimin e këtij ligji janë: organizatat jofitimprurëse të cilat ushtrojnë veprimtari në fushën e luftës ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje; profesionet e lira dhe urdhrat e psikologut dhe të punojësit social, media dhe subjektet private sipas detyrave të përcaktuara për zbatimin e këtij ligji. Ligji ka një paketë të detajuar me përgjegjësi/detyra të përgjithshme që garantojnë zbatimin në tërësi të ligjit dhe si të tilla i përkasin çdo autoriteti sikurse ka dhe përgjegjësi/detyra që lidhen ngushtësisht me fushën e veprimtarisë së tyre specifike.

4. Mbledhja dhe Analiza e të Dhënave. Ligji i ri do të garantojë që të dhënat të mbledhen dhe analizohen në mënyrë të rregullt, duke mundësuar matjen e progresit të parandalimit dhe mbrojtjes dhe identifikimin e fushave ku ka nevojë për ndërhyrje shtesë. Kjo do të ndihmojë në krijimin e politikave më të sakta dhe të bazuara në fakte për aspekte të lidhura me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Autoriteti kryesor përgjegjës bashkërendon punën për mbledhjen dhe mbajtjen e të dhënave statistikore nga autoritetet përgjegjëse dhe subjektet publike e private dhe paraqet raportin vjetor pranë komisionit përgjegjës parlamentar/nënkomisionin për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës ndaj grave.

5. Integrimi i Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor. Një nga elementët më të rëndësishëm të ligjit të ri është integrimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të gjitha politikat publike. Kjo do të sigurojë ndarje efektive të burimeve financiare për politika dhe programe që promovojnë barazinë gjinore, duke e bërë këtë një prioritet të qartë në planifikimin ekonomik të vendit.

6. Përfshirja e sektorëve. Ligji i ri do të adresojë detyra konkrete në sektorë kyç, si i rendit dhe sigurisë publike; shëndetësisë; drejtësisë; arsimit, punësimit, informimit publik dhe medias dhe institucionet e varësisë; Mekanizmi i Koordinuar i Referimit dhe NJQV, etj. Ligji synon forcimin e sistemit gjyqësor për marrjen e masave të menjëhershme të mbrojtjes ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje; Përmes mekanizmave specifikë, do të krijohen politika për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave.

7. Përbushja e detyrimeve ndërkombëtare. Shqipëria ka detyrime për të zbatuar standardet ndërkombëtare për mbrojtjen dhe parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Ligji i ri do të ndihmojë vendin të përmirësojë raportet e saj me organizatat ndërkombëtare, duke treguar një angazhim serioz për reduktimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Kjo do të ndikojë pozitivisht në procesin e integritetit evropian dhe në tërheqjen e fondeve dhe investimeve për programe të lidhur me çështjet e fuqizimit të grave, eliminimit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Kosto dhe Përfitimi i Opsionit të Preferuar:

Efekti i përgjithshëm financiar është vlerësuar **2 014.1 milion lekë** i shpërndarë në dhjetë vite ose sa 7.3% e PBB së parashikuar për vitin 2026. Shumat sipas viteve në milionë lekë janë: (2026 -148.7 milionë; 2027- 222.7 milionë;

2028 - 322.7 milionë, 2029 - 160 milionë, 2030 - 260 milionë, 2031 - 160 milionë, 2032 - 160 milionë, 2033 - 160 milionë, 2034 - 160 milionë dhe 2035- 260 milionë). Pjesa tjetër e shpenzimeve mbulohet nga tavanet buxhetore të miratuara të autoriteteve përgjegjëse.

Sa më sipër, hartimi i një ligji të ri është zgjidhja më e mirë, sepse ai garanton një qasje të fortë, të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse ndaj kësaj çështjeje thelbësore. Ai siguron mekanizma të qartë zbatimi, struktura profesionale dhe me profil të qëndrueshëm dhe një përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare, duke e bërë parandalimin e dhunës një realitet të prekshëm.

Miratimi i këtij projektligji do të sjellë përfitime afatgjata dhe gjithëpërfshirëse për shoqërinë në përgjithësi dhe gratë e grupet e cënueshme në vecanti. Ky ligj zgjeron ndjeshëm fushën e zbatimit, duke përfshirë jo vetëm sferën publike por edhe atë private, si dhe format e tjera të dhunës ndaj grave, jo vetëm dhunën në marrëdhëniet familjare. Mbështetja e përgjithshme dhe e specializuar për viktimat ofrohet falas. Një tjetër aspekt i rëndësishëm është rritja e mbrojtjes ndaj të gjitha formave të dhunës, duke parashikuar urdhëra mbrojtjeje për secilën formë bazuar në specifikat e viktimës dhe masave që merren, si: për masat e mbrojtjes ndaj dhunës në familje; për masat e mbrojtjes nga dhuna e lehtësuar nga teknologjia; për masat mbrojtëse ndaj dhunës ndaj grave në politikë, përfshirë formën digjitale të dhunës; për masat mbrojtëse ndaj dhunës dhe ngacmimit, përfshirë në punë dhe formën digjitale të dhunës. Ai gjithashtu parashikon masa civile dhe administrative për të siguruar zbatimin e rregullave kundër dhunës ndaj grave nga të gjitha subjektet publike dhe private.

Kostoja e përllogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
148,700	222,700	322,700

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Projektligji është hartuar dhe koordinuar nga MSHMS me kontributin e Grupit Teknik Ndërinstitucional të Punës, të ngritur me Urdhrin e ministrit nr.179, datë 30.04.2025 “Për ngritjen dhe funksionimin e grupit teknik ndërinstitucional të punës për hartimin e ndryshimeve në Ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar”.

Grupi i Punës përbëhet nga përfaqësues të MSHMS (Zëvendësministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në cilësinë e kryetarit, si dhe anëtarët: Drejtori i Përgjithshëm i Zhvillimit të Mbrojtjes Sociale; Drejtori i Përgjithshëm i Politikave të Shëndetësisë; Drejtori i Barazisë Gjinore; Drejtori i Programimit, Harmonizimit, Kuadrit Rregullator; Drejtori i Politikave të Përkujdesjes Sociale dhe Shërbimeve Sociale të Integruara), si dhe përfaqësues nga: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

Grupi i Punës realizoi disa takime, në bashkëpunim të ngushtë me ekspertet kombëtare (Arta Mandro, Arjana Fullani, Mariana Semini, Iris Aliq) që u angazhuan nga UNDP dhe UN WOMEN për të lehtësuar procesin e hartimit të projektligjit. Në takimet e zhvilluara u identifikua paraprakisht nevoja e hartimit të ligjit të ri për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Mendimet e përcjella nga Grupi i Punës u pasqyruan pas çdo takimi konsultues në projektligjin e përgatitur.

Grupi i punës dhe ekspertet realizuan takim në datën 3 korrik 2025, si dhe takime konsultative me grupe të ndryshme interesi, si vijon:

- Me grupin e punës, nëpunësit gjinorë, përfaqësues nga Bashkia Tiranë (KVDHF Tiranë) - me datë 04.09.2025;
- Me 61 Koordinatorët Vendorë Kundër Dhunës në Familje - me datë 04.09.2025 (takim online);
- Me përfaqësues të shoqërisë civile, si: Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS), Qendra të Ndryshëm dhe të Barabartë (QDNJD), Linja e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKGv), Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim

(GADC), GIZ Albania, NISMA ARSIS, VATRA, Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA), Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AËEN), Rrjeti i Barazisë në Vendimmarrje, Qendra Strehëza “Edlira Haxhiymeri”, Qendra për Drejtësi Gjinore, Aleanca LGBTI, Forumi i Gruas Elbasan, Shoqata e Grave “Refleksione”, Qendra Komunitare “Sot për të ardhmen”, Shoqëria Kristiane e të Burgosurve të Shqipërisë (SHKBSH), Amabasada Suedeze, UNICEF, UN EOMEN, UNDP - me datë 09.09.2025. Organizatat u ftuan të përcillnin mendimet e tyre edhe me shkrim.

- Me institucionet e të drejtave të njeriut, si: Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Dhoma Kombëtare e Avokatëve, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, Avokatë ofrues të shërbimit ligjor falas, Urdhri i Psikologut, Urdhri i Punonjësve Socialë - me datë 09.09.2025;
- Me përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK), Policia e Shtetit-Drejtoria e Krimit Kibernetik, OJF e mediave, me datë 10.09.2025;
- Me përfaqësues nga Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë Gjyqësor, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Gjyqtarë, Prokurorë, Përmbarues Gjyqësorë, Akademia e Sigurisë, Shkolla e Magjistraturës, me datë 10.09.2025.

Nga takimet konsultative të zhvilluara, u diskutua nevoja e hartimit të një ligji të ri.

Mendimet dhe sugjerimet e dërguara me shkrim nga grupet e interesit, institucione të tjera të përfshira në procesin konsultativ si dhe sugjerimet e marra nga konsultimi publik janë reflektuar në tekstin e projektligjit.

Gjithashtu, draft projektligji u publikua sipas parashikimeve të ligjit Nr. 146/2014 'Për Njoftimet dhe Konsultimin Publik', në platformën virtuale të njoftimeve dhe konsultimit publik, për t'ju njohur nga publiku i gjerë në vazhdimësi të mbledhjes së komenteve dhe rekomandimeve. Draft projektligji u publikua në datën 6 tetor 2025, në linkun <https://ëë.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/883> dhe pati rreth 888 shikues.

Projektligji iu dërgua për mendim nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me shkresën “Dërgohet për mendim një projektligji” me nr. 4145 prot., datë 24.10.2025 këtyre institucioneve:

Ministrisë së Drejtësisë; Ministrisë së Financave; Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit; Ministrisë së Arsimit; Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit; Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës; Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme; Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministrisë së Brendshme; Ministrisë së Mbrojtjes; Ministrit të Shtetit për Pushtetin Vendor; Ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin; Ministrit të Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin; Ministrit të Shtetit dhe Kryenegociatorit; Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës; Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore; Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; Avokatit të Popullit; Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit; Autoritetit të Mediave Audiovizive; Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Institutit të Statistikave; Departamentit të Administratës Publike.

Disa institucionet kthyen përgjigje duke u shprehur **dakord sipas fushës së tyre të kompetencës**, e konkretisht: **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme; Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural; Ministria e Mjedisit; Ministër Shteti për Pushtetin Vendor; Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit.**

Disa institucione kthyen përgjigje me sugjerimet apo rekomandimet përkatëse, sipas fushës së tyre të kompetencës, e konkretisht:

Ministria e Drejtësisë; Ministria e Punëve të Brendshme; Ministria e Financave; Ministria e Mbrojtjes; Ministria e Arsimit; Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin; Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin; Ministër i Shtetit dhe Kryenegociator; Prokuroria e Përgjithshme; Këshilli i Lartë i Prokurorisë; Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi; Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale; Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare; Autoriteti i Mediave Audiovizuale; Urdhri i Punonjësve Socialë; Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas; Prania e OSBE-së në Shqipëri.

Ndërsa nga grupet e interesit, sugjerime u dërguan nga grupi kërkimor në kuadër të projektit të EYDR, një projekt Erasmus Youth.

Në mënyrë të përmbledhur për secilin institucion, rekomandimet dhe reflektimet në lidhje me pranimin ose jo të tyre, janë dhënë në relacionin e projekt-ligjit me argumentat përkatëse.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Struktura përgjegjëse është Ministria që mbulon çështjet e barazisë gjinore dhe çështjet sociale (aktualisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale). Gjithashtu grupi i punës për hartimin e këtij projektligji ka anëtarë nga institucione të tjera si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Pushtetit Vendor, Perfaqësues nga DP e policisë së Shtetit.

Pa u kufizuar, autoritetet e tjera përgjegjëse të linjës përfshijnë: gjithë ministrinë dhe institucionet e tjetra të administratës publike në nivel qendror sipas kompetencave dhe fushës së përgjegjësisë dhe institucionet e tyre të varësisë; Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe strukturat e tjera të përfshira në MKR; organizatat jofitimprurëse të cilat ushtrojnë veprimtari në fushën e luftës ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje; profesionet e lira dhe urdhrat e psikologut dhe të punojësit social, media dhe subjektet private.

Për zbatimin e këtij projektligji ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si dhe subjektet e tjera publike dhe private të përcaktuara në projektligj. Pa u kufizuar në përgjegjësitë e MSHMS, autoritetet e tjera përgjegjëse përfshijnë:

- a) Ministrinë për çështjet e rendit dhe sigurisë
- b) Ministrinë për çështjet e drejtësisë
- c) Ministrinë për çështjet e arsimit
- d) Autoritetet e informimit publik dhe medias
- e) Njësitë e Vetëqeverisjes vendore;
- f) Organizatat jofitimprurëse të cilat ushtrojnë veprimtari në fushën e luftës kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
- g) Subjektet private.

Rol thelbësor në monitorimin e zbatimit të këtij projektligji dhe akteve nënligjore të tij do të këtë Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe sektorët nën varësinë e saj. Gjithashtu, do të kenë rol të rëndësishëm policia e shtetit, gjykatat dhe përmbartuesit gjyqësorë për sa i përket masave të mbrojtjes, Mekanizmi Kombëtar i Referimit, koordinatorët vendorë për referimin e dhunës si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të opsionit të preferuar do të realizohet nga MSHMS në bashkëpunim me INSTAT, përmes mbajtjes, analizimit dhe publikimit të të dhënave vjetore për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, përfshirë femicidin, në përputhje me ligjin për statistikat zyrtare, legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe metodologjitë e INSTAT-it. Autoriteti kryesor përgjegjës MSHMS dhe INSTAT përgatisin të dhëna të disagreguara mbi të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke përfshirë në mënyrë të veçantë rastet e femicidit, me qëllim monitorimin dhe hartimin më efektiv të politikave mbrojtëse dhe parandaluese. Çdo pesë (5) vjet, autoriteti kryesor përgjegjës dhe INSTAT-i realizojnë studimin kombëtar të prevalencës së të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Botimi bëhet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për statistikat zyrtare.

PJESA 2: BAZA KRYESORE E ANALIZËS DHE E PROVAVE

Historik

Jepni kontekstin e politikës.

Ligji aktual nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar, ka hyrë në fuqi në Qershor të vitit 2007. Ky ligj ka për qëllim kryesor parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje në të

gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore si dhe garantimin e mbrojtjes me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimë të dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Nga viti 2007 kur ligji ka hyrë në fuqi janë bërë katër ndryshime dhe/ose ndryshime lidhur me përmbajtjen e këtij ligji, e konkretisht:

- 1) Ligji Nr. 9914, datë 12.5.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, i cili ka shtuar edhe Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës si autoritet me përgjegjësi për marrjen e masave për edukimin e brezit të ri me mendësitë dhe rregullat e sjelljes së mirë, si dhe të ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare; marrjen e masave për krijimin e qendrave të rritjes së fëmijëve, ndaj të cilëve është ushtruar dhunë, ose kur prindërit e tyre kryejnë vepra dhune ndaj njëri-tjetrit. Ministria e Arsimit dhe Shkencës është ngarkuar me detyrat e hartimit të programeve mësimore për shkollat e mesme dhe të larta për rregullat e sjelljes në familje; përgatitjen e teksteve shkollore dhe materiale të tjera plotësuese për edukimin e nxënësve dhe/ose studentëve me mendësitë e ndalimit të dhunës në marrëdhëniet familjare.
- 2) Ligji Nr.10 329, datë 30.9.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, të ndryshuar, ku është parashikuar ngritja e një qendre kombëtare të shërbimit të përkujdesit shoqëror për viktimat e dhunës në familje. është shtuar më tej detyrimi për konfidencialitetin e subjekteve raportuese, punonjësit e shërbimit të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, pranë institucioneve publike dhe organizatave jofitimprurëse të licencuara, si dhe avokatët e përfaqësuesit ligjorë të viktimave të dhunës në familje ruajnë fshehtësinë e të dhënave personale dhe të informacioneve që viktimat jep për situatën e saj, përveçse kur përcaktohet ndryshe me shkrim nga viktimat. Ky ligj ka përcaktuar ngritjen e mekanizmit të bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe që mënyra e procedimit të tij për mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Në masat e mbrojtjes është shtuar që vendimi i gjykatës parashikon pezullimin e lejes së armës ose kthimin e armës së sekuestruar, nëse personi ka një autorizim për armëmbajtje me leje, vetëm pas mbarimit të afatit të përcaktuar në urdhrat e mbrojtjes. është shtuar që Dhoma Kombëtare e Avokatisë dhe Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike u njoftojnë gjykatave listën e avokatëve, që autorizohen për dhënien e ndihmës juridike falas. Viktimat/ kërkuesit shkarkohen nga të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifa për shpenzimet gjyqësore, si dhe ato të shërbimeve përmbartimore shtetërore. Me lëshimin e urdhrat të mbrojtjes, shpenzimet gjyqësore i ngarkohen palës që ka ushtruar dhunë në familje. Janë shkurtuar afatet për lëshimin nga gjykata të urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes për të miturit në 24 orë ndërsa për subjekte të tjera në 48 orë nga paraqitja e kërkesës për mbrojtje, si dhe është parashikuar që vendimi i gjykatës i njoftohet edhe përmbartuesit gjyqësor.
- 3) Ligji Nr.47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, të ndryshuar, i cili ka sjellë disa shtesa në qëllimin e ligjit përveç masave ligjore edhe masave të tjera të nevojshme për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje, si dhe mbrojtjen edhe të çdo individ, subjekt i këtij ligji, që paraqet nevoja të veçanta mbrojtjeje. Ky ligj ka sjellë disa shtesa në drejtim të përkufizimeve, legjislacionit të zbatueshëm, subjekteve që mbrohen, autoriteteve përgjegjëse duke shtuar gamën dhe përgjegjësitë e tyre, shtimin e përgjegjësisë për autoritetin kryesor përgjegjës MSHMS, garanci të shtuara për mbrojtjen në drejtim të strehimit, transportit në strehim të sigurt, shërbime urgjence dhe shërbime mjekësore, masa të tjera mbrojtjeje ndaj dhunës në familje që mund të vendosen nga gjykata, shtesa dhe ndryshime në lidhje me kërkesëpadinë, me urdhrat e mbrojtjes dhe urdhrat e menjëhershëm të mbrojtjes , etj. Ndër ndryshimet më të rëndësishme të këtij ligji ishte parashikimi i lëshimit të Urdhrave për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme nga policia e shtetit.
- 4) Ligji nr.125/ 2020 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, të ndryshuar, solli ndryshime në riformulimin e qëllimit të ligjit, të përkufizimit të dhunuesit, rregullime të reja për rehabilitimin e dhunuesit, parashikimin e lëshimit të urdhrat për masat paraprake për mbrojtjen e menjëhershme nga policia e shtetit edhe kur në të gjithë vendin ose në një pjesë të territorit të tij janë vendosur masat e jashtëzakonshme, dhe se policia duhet t'i kërkojë gjykatës lëshimin e urdhrat të mbrojtjes, pa kërkuar paraprakisht nxjerrjen e urdhrat të menjëhershëm të mbrojtjes, gjatë gjithë

periudhës së zgjatjes së masave të jashtëzakonshme. Sipas këtij ligji, vendimi për urdhrin e mbrojtjes dhe urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes regjistrohet në një regjistër të veçantë, i cili administrohet pranë çdo gjykate sipas modelit, rregullave dhe procedurave që miratohen me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Parashikimet në lidhje me ankimin janë riformuluar, si dhe është shtuar që ë çdo rast, punonjësi i policisë, ku paraqitet për mbrojtje viktime, e referon rastin në organin e prokurorisë për ndjekjen penale të dhunuesit, sipas rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Ndër ndryshimet kryesore të këtij ligji është parashikimi i masës së mbrojtëse të dhunës në familje, nga gjykata dhe policia e shtetit, për urdhërimin menjëherë të largimit të dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, kur viktime dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë. Gjykata, kur është rasti, në vendosjen e kësaj mase merr në konsideratë nevojat e veçanta të dhunuesit të mitur, të moshuar ose personit me aftësi të kufizuara dhe në këto raste urdhri i largimit nga banesa vendoset vetëm kur asnjë masë tjetër nuk garanton mbrojtjen e viktimës nga dhuna. Përveç masës së largimit të dhunuesit nga banesa, mbrojtja ndaj dhunës në familje, sigurohet dhe me mënyrat e tjera në zbatim të këtij ligji.

Qëllimi i ligjit është që të parandalojë dhe të zvogëlojë dhunën në familje në të gjitha format e saj dhe të mbrojë viktimat përmes një procedure të shpejtë, të përbalueshme dhe të thjeshtë. Dy përmirësimet më të rëndësishme të këtij ligji, në vitet 2018 dhe 2020, përmbushin rekomandimet e dhëna nga Komiteti CEDAË (2016) dhe nga GREVIO (2017). Nëpërmjet ndryshimeve të bëra, u forcuan masat mbrojtëse dhe procedurale për një përgjigje më efektive ndaj dhunës në familje dhe mbrojtja e viktimave, përmes lëshimit të urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, i paraprirë nga vlerësimi i riskut, për çdo rast që trajtohet. Gjithashtu, për herë të parë, mbrohen gratë dhe vajzat në marrëdhënie intime, pa pasur lidhje formale me dhunuesit, si martesë ose bashkëjetesa.

Në kuadër të legjislacionit dytësor, ligji nr.9669/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, i ndryshuar, është shoqëruar me miratimin e disa akteve me karakter nënligjor.

Në zbatim të ligjit nr. 47/2018, janë miratuar katër udhëzime:

- Udhëzimi nr. 816, datë 27.11.2018 i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, “*Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve dhe të funksionimit të qendrave të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale*”;
- Udhëzimi nr. 912, datë 27.12.2018, i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i ministrit të Brendshëm, “*Për procedurat dhe modelin e urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme*”;
- Udhëzimi Nr. 866, datë 20.12.2018 “*Për procedurat dhe modelin e vlerësimit të riskut për rastet e dhunës në familje*”, i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i ministrit të Brendshëm.
- Udhëzim nr. 9, datë 17.6.2020, i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë dhe i Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për përcaktimin e rregullave për krijimin e një baze të dhënash të posaçme për çështjet e dhunës në familje në gjykata dhe unifikimin e regjistrimit të tyre”(ndryshuar me udhëzimin e përbashkët nr. 7, datë 15.6.2021).

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në zbatim të kompetencave të saj ka miratuar disa akte nënligjore që lidhen me procedurat standarde të trajtimit të rasteve të evidentuara të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, në kuadër të mekanizmit MKR, si:

- Urdhëri Nr.100, datë 21.2.2020 “*Për procedurat standarde të veprimit (PSV) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore nga punonjëset/ punonjësit e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të mekanizmave të koordinuar të referimit (MKR)*” i MSHMS.
- Urdhëri Nr.101, datë 21.2.2020 “*Për miratimin e procedurave standarde të veprimit (PSV) për trajtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore nga punonjëset/punonjësit e shërbimeve shëndetësore, në kuadër të bashkëpunimit si anëtarë të mekanizmit të koordinuar të referimit (MKR)*” i MSHMS.
- Urdhëri nr.102, datë 21.2.2020 “Për miratimin e “*Për procedurat standarde të veprimit (PSV) për punonjëset/punonjësit e shërbimeve shëndetësore, për zvogëlimin e rrezikut të përjetimit të dhunës në familje e të dhunës me bazë gjinore, në situata të emergjencave civile*” i MSHMS.

VKM Nr. 327, datë 2.6.2021 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimitin e viktimave të dhunës”, lidhet ngushtësisht me zbatimin e ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006 dhe krijon mekanizmin e duhur ndërinstitucional për çështjet e dhunës në familje dhe mbështetjen e viktimave të kësaj dhune.

Me qëllim garantimin e progresit në reduktimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në marrëdhëniet familjare në nivel qendror dhe vendor, Këshilli i Ministrave, me vendimin Nr. 400 datë 30.6.2021 miratoi Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 (SKBGJ 2021-2030) dhe Planin e saj të Veprimit. Së bashku me këto dy dokumente strategjike u miratua edhe Pasaporta e Treguesve, me anë të së cilës janë përcaktuar tregues të matshëm të realizimit të objektivave të kësaj strategjie. Strategjia është përgatitur nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale , në koordinim dhe konsultim me ministritë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, akademinë, si dhe organizatat ndërkombëtare, të angazhuara në luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, në Shqipëri.

Problemi në shqyrtim:

1. Përshkruani natyrën e problemit.
2. Identifikoni shkaqet e problemit.
3. Përshkruani shtrirjen e problemit.
4. Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.
5. Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.

Ligji aktual “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (9669/2006 i ndryshuar) ka disa mangësi të cilat duhet të përmirësohen. Ai nuk është plotësisht i harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit Evropian si Direktivën e (BE-së) nr.1385/2024, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14 maj 2024, “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, Konventën e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, Konventën nr. 190 “Mbi dhunën dhe ngacmimin në botën e punës” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, raportet e GREVIO-s dhe rekomandimet e Komisionit Evropian për Shqipërinë.

Për më tepër, ai nuk reflekton nevojën për mbrojtje ndaj dhunës jashtë sferës së marrëdhënieve familjare, duke krijuar një boshllëk në zbatimin efektiv të masave kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Parandalimi dhe reduktimi i dhunës ndaj grave si dhe mbështetja me shërbime të përgjithshme e të vecanta ndaj vikimave të dhunës nuk është arritur ende në vend.

Raporti për Shqipërinë 2024¹, i Komisionit Evropian thekson se: “Korniza ligjore për dhunën me bazë gjinore nuk është plotësisht në përputhje me Konventën e Stambollit. Dhuna ndaj grave dhe vajzave mbetet një çështje urgjente që duhet të adresohet. Numri i lartë i vazhdueshëm i femicideve për frymë është ende një shqetësim serioz. Zbatimi nga policia i urdhrave të mbrojtjes mbetet joefikas, duke rezultuar në pandëshkueshmërinë e dhunës. Llogaridhënia e dobët e policisë në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave është një shqetësim. Avokati i Popullit ngriti një Vëzhgim të Femicideve për të raportuar dhe monitoruar rastet e femicideve. Shërbimet mbështetëse për viktimat e dhunës vazhdojnë të jenë të drejtuara nga donatorët dhe të pamjaftueshme, veçanërisht në kujdesin shëndetësor, financimin e strehimoreve, ndihmën ligjore falas dhe riintegrimin dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës. Mekanizmat e koordinimit duhet të përmirësohen ndjeshëm në fushat e trafikimit të fëmijëve, krimet kibernetik, martesës së fëmijëve, abuzimit seksual të fëmijëve dhe të drejtës për kujdes shëndetësor dhe arsim.” Për të drejtat themelore raporti vëren progres në disa fusha sidomos në të drejtat e viktimave gjithashtu u bën thirrje autoriteteve të intensifikojnë përpjekjet për zbatim në përgjithësi, sidomos në fushën e dhunës kundër grave dhe duke zbatuar efektivisht agjendën kombëtare për të Drejtën e Fëmijëve.

¹ https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania%20Report%202024.pdf, fq.39-40.

Nevoja për ndërmarrjen e kësaj nisme është bazuar në disa tregues dhe nevoja konkrete si dhe në kuadrin legjislativ dhe të politikave shtetërore.

Problemi: Mospërputhja dhe mungesa e harmonizimit të plotë të legjislacionit aktual që trajton dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje me ndryshimet e fundit të Ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Më konkretisht:

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi është ndryshuar në vitin 2020, duke përfshirë forma të reja diskriminimi (si diskriminimi i shumëfishtë, ndërsektorial, gjuha e urrejtjes, etj.) dhe baza të reja diskriminimi.

Megjithatë, dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje ende nuk trajtohen shprehimisht si forma diskriminimi për shkak të gjinisë në legjislacionin përkatës. Kjo krijon mungesë koherence ligjore dhe institucionale midis ligjeve që mbrojnë nga diskriminimi dhe atyre që trajtojnë dhunën. Së pari, nevoja për harmonizimin me ndryshimet e Ligjit nr.10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”: Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” është ndryshuar në 2020 me qëllim harmonizimin e tij me legjislacionin evropian në këtë fushë si edhe plotësimin dhe përmirësimin e boshllëqeve të identifikuara nga analiza e zbatueshmërisë së tij nga viti 2010. Ndryshimet në këtë ligj referojnë kryesisht në shtimin e formave të diskriminimit dhe shtimin e shkaqeve/ bazave të diskriminimit duke njohur edhe forma të reja diskriminimi, si diskriminimi i shumëfishtë/ ndërsektorial/ gjuha e urrejtjes, etj. Këto ndryshime shtrojnë nevojë për ta konsideruar “dhunën ndaj grave” dhe “dhunën në familje” si formë të diskriminimit për shkak të gjinisë.

Së dyti, mungesa e përditësimit dhe harmonizimit të ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” me ndryshimet e bëra në legjislacionin tjetër përkatës, konkretisht në Kodin e Punës dhe në Kodin e Mediave Audiovizive.

Ligji aktual për dhunën në marrëdhëniet familjare **nuk pasqyron** ndryshimet e bëra në **Kodin e Punës**, të cilat:

- ndalojnë diskriminimin në punësim,
- parashikojnë mbrojtjen nga dhuna dhe ngacmimi në vendin e punës, përfshirë ngacmimin seksual,
- garantojnë respektimin e personalitetit dhe dinjitetit të punëmarrësit.

Po ashtu, nuk janë reflektuar ndryshimet e vitit 2022 në Kodin e Mediave Audiovizive, që lidhen me:

- parandalimin e gjuhës së urrejtjes dhe stereotipeve gjinore,
- promovimin e barazisë gjinore në përmbajtjet mediatike.

Pra, problemi themelor është:

Ligji aktual për dhunën në marrëdhëniet familjare është i papërditësuar dhe i paharmonizuar me zhvillimet e fundit ligjore në fusha të tjera që lidhen drejtpërdrejt me mbrojtjen nga dhuna dhe diskriminimi me bazë gjinore, duke krijuar boshllëqe në mbrojtjen ligjore dhe në zbatimin praktik të të drejtave të grave dhe viktimave të dhunës.

Mungesa e harmonizimit të ligjit kombëtar “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” me kuadrin e ri ligjor të Bashkimit Evropian në fushën e mbrojtjes nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje. Më konkretisht:

Ligji aktual është miratuar në vitin 2006 dhe bazohet në standarde ndërkombëtare të asaj kohe, ndërsa prej atëherë ka pasur zhvillime të rëndësishme në nivel të BE-së, përfshirë:

- Direktivën (BE) 2024/1385, e cila përcakton masa gjithëpërfshirëse për parandalimin, mbrojtjen dhe ndëshkimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;
- ndryshimet në direktivat ekzistuese që kanë forcuar standardet për mbrojtjen e viktimave dhe përgjegjësinë e institucioneve publike.

Ligji shqiptar nuk pasqyron ende këto standarde të reja, veçanërisht në fushat që lidhen me: definimin e zgjeruar të formave të dhunës (fizike, seksuale, psikologjike, ekonomike, dixhitale);

- mekanizmat e raportimit dhe aksesin në drejtësi për viktimat;
- detyrimet e institucioneve publike dhe sektorit privat për parandalim dhe trajtim të rasteve.

Pra, problemi kryesor është: Ligji aktual për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare është i vjetëruar dhe jo i harmonizuar me acquis të BE-së, në veçanti me Direktivën (BE) 2024/1385, çka krijon një mospërputhje midis

kuadrit kombëtar dhe atij evropian dhe pengon përmbushjen e standardeve të reja të mbrojtjes së grave dhe viktimave të dhunës në familje.

Së treti, në nivel ndërkombëtar ligji për masat ndaj dhunës në marrëdhënie familjare ka nevojë të harmonizohet me Acquis të Bashkimit Evropian në fushën kundër dhunës ndaj grave (direktivat e reja dhe ndryshimet në direktivat që kanë qenë në fuqi edhe në 2006 kur u miratua fillimisht ligji aktual). Me rëndësi në këtë drejtim është sidomos harmonizimi me Direktivën (BE) 2024/1385 të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 maj 2024 “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” që garanton mbrojtje gjithëpërfshirëse nga të gjitha format e dhunës.

Gjithashtu, nevoja për ndryshimin dhe për ndërmarrjen e kësaj nisme është evidentuar edhe nga Komitetet dhe organizmat ndërkombëtare:

- Komiteti CEDAE, në 2017 përditësoi rekomandimin e përgjithshëm nr. 19, duke miratuar rekomandimin e përgjithshëm nr.35, mbi dhunën me bazë gjinore ndaj grave (CEDAE/C/GC/35), sipas të cilit, dhuna me bazë gjinore ndaj grave: *“është një nga mjetet themelore shoqërore, politike dhe ekonomike, me të cilat vazhdon pozita vartëse e grave në lidhje me burrat dhe rolet e tyre stereotipike”*. Komiteti rekomandon që shteti: të marrë masa për të inkurajuar gratë që të raportojnë rastet e dhunës me bazë gjinore, duke ofruar ndihmë juridike falas deri në zonat rurale dhe të largëta dhe duke vendosur shërbimin telefonik 24-orësh; të forcojë rolin dhe kapacitetet e autoriteteve përkatëse në lidhje me mbrojtjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore, në përputhje me standardet ndërkombëtare; të rrisë numrin dhe kapacitetet e strehave shtetërore, të rrisë financimin e strehave që drejtohen nga organizatat joqeveritare dhe të vërë në funksion mekanizmat për kontraktimin, delegimin ose marrjen e shërbimeve të organizatave jo-qeveritare në mënyrë që t’u përgjigjen nevojave të të gjitha grave që janë viktimat të dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë gratë Rome dhe Egjiptiane, gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë që jetojnë në zonat rurale dhe të largëta; të forcojë sistemin e zbatimit të vendimeve të gjykatës, që kanë të bëjnë me urdhrat për mbrojtje apo urdhrat për mbrojtje emergjente, për viktimat të dhunës me bazë gjinore, duke përfshirë ngritjen e kapaciteteve të personelit gjyqësor (përmbaruesit gjyqësor).

- Gjithashtu, Grupi i Ekspertëve të Konventës së Stambollit (GREVIO) kanë lënë një sërë masash të përgjithshme dhe specifike, për shtetin shqiptar, të cilat shtojnë detyrimin për ta harmonizuar ligjin shqiptar në fushën e dhunës ndaj grave me rekomandimet e lëna nga GREVIO. Raporti i 24 Dhjetorit 2017 për Shqipërinë, përmban një analizë të përgjithshme të zbatimit të dispozitave të Konventës së Stambollit. Ai nënvizon iniciativat pozitive në parandalimin dhe luftimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në nivel kombëtar dhe jep sugjerime dhe propozime për të përmirësuar situatën e grave që përballen me një dhunë të tillë. Për propozimin e këtyre masave, GREVIO ka bërë rekomandimet sipas niveleve të ndryshme të urgjencës, duke vënë në dukje që të gjitha janë të rëndësishme.

-Gjithashtu, kuadri ligjor aktual nuk adreson format e reja të dhunës që kanë dalë si pasojë e zhvillimeve shoqërore, teknologjike dhe profesionale, si **dhuna e lehtësuar nga teknologjia, dhuna në mjedisin punës dhe dhuna në proceset zgjedhore dhe në politikë**, duke krijuar boshllëqe në mbrojtjen efektive të viktimave dhe në parandalimin e këtyre formave të reja të dhunës..

Nga ana tjetër, problematikat që lidhen me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje dhe mungesën e mekanizmave efektivë për parandalim, reduktim, mbështetje dhe mbrojtje prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë gratë, vajzat, grupet e cënueshme, fëmijët viktimat dhe dëshmitarët të dhunës, personat në varësi, të huajt dhe azilkërkuesit, etj

Arsyeja e ndërhyrjes

1. Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.
2. Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.
3. Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.
4. Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.

Qeveria shqiptare e sheh të nevojshme ndërhyrjen për shkak të mungesës së harmonizimit të plotë të ligjit ekzistues për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare me legjislacionin evropian në këtë fushë si edhe plotësimin dhe përmirësimin e boshllëqeve të identifikuar nga analiza e zbatueshmërisë së tij. Nevoja e ndërhyrjes së qeverisë

lidhet me rëndësinë e zbatimit të parimit zero tolerancë ndaj dhunës duke përfshirë përveç mbrojtjes nga dhuna në familje edhe mbrojtjen nga dhunë në marrëdhëniet e punës, në aktivitetet sociale dhe politike, nga dhuna dhe ngacmimi seksual, përfshirë dhunën e lehtësuar nga teknologjia, nga ana tjetër. Nevoja për ndërmarrjen e kësaj politike diktohet nga domosdoshmëria për të analizuar për herë të parë pasojat që vijnë nga diskriminimi dhe nga të gjitha format e dhunës.

Qeveria synon të ndërmarrë një politikë, e cila parashikon evidentimin e shkaqeve/bazave të diskriminimit duke njohur edhe forma të reja diskriminimi, si diskriminimi i shumëfishtë/ ndërsektorial/ gjuhën e urrejtjes, etj.

Ndryshimet e fundit në legjislacionin vendas dhe zhvillimet në standardet ndërkombëtare kanë evidentuar boshllëqe ligjore dhe vështirësi në garantimin e mbrojtjes efektive ndaj dhunës drejtuar grave, çka kërkon përshtatjen me standardet bashkëkohore të mbrojtjes nga dhuna me bazë gjinore. Mungesa e efikasitetit të ligjit aktual për masat ndaj dhunës në familje është evidentuar edhe nga Komisioni Evropian në Progres Raportet e Komisionit Evropian 2022-2024. Për më tepër, qeveria duhet të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga *acquis* e BE-së dhe nga angazhimet ndërkombëtare si CEDAË dhe GREVIO.

Shteti shqiptar nëpërmjet Strategjisë Kombëtare për Barazinë gjinore 2021-2030 thekson përparësinë dhe vëmendjen e veçantë që qeveria e Shqipërisë i kushton zvogëlimin të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke e konsideruar adresimin e duhur të tyre si kushte drejt një zhvillimi të qëndrueshëm. Parimet kryesore që udhëheqin SKBGJ 2021–2030, në rastin konkret lidhen me tolerancën zero kundrejt dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, me qëllim mbrojtjen e jetës, dinjitetit dhe integritetit njerëzor, si një parakusht për zhvillimin e një vendi, pasi çdo formë dhune është sulm mbi dinjitetin njerëzor dhe shkelje e të drejtave të njeriut, ndaj nuk duhet të tolerohet.

Duke marrë parasysh se çështjet e dhunës ndaj grave janë të ndjeshme në të gjitha fushat, Strategjia për Barazinë Gjinore është konceptuar si një strategji “ombrellë” e cila përmban objektiva specifike dhe masa nën përgjegjësinë e një numri të madh institucionesh qendrore dhe Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore. Në këtë kuptim, “SKBGJ 2021–2030” shërben si një udhërrëfyes drejt një shoqërie ku të gjithë individët gra, burra, të reja, të rinj, vajza e djem, pavarësisht moshës, gjinisë, vendlindjes e vendbanimit, grupit etnik apo social, aftësive të kufizuara, përkatësisë e besimit fetar, shprehjes së identitetit gjinor e orientimit seksual, si dhe karakteristikave të tjera individuale, të jetojnë në një mjedis pa dhunë.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 290, datë 11.4.2020 “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të Sistemit Informatik të Planifikimit të Integruar (SIPI/IPSIS), Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021 – 2030” është një dokument i konsultuar gjerësisht me ministrinë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, akademinë, si dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë për reduktimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, në Shqipëri.

Nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje, qeveria synon të:

- Harmonizojë legjislacionin kombëtar me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare mbi mbrojtjen e grave nga dhuna, dhunën në familje dhe të drejtat e njeriut.
- Forcojë mekanizmat për zbatimin e mbrojtjes nga diskriminimi dhe dhuna ndaj grave në familje dhe më gjerë, duke krijuar instrumente efektive për monitorimin dhe vlerësimin e progresit dhe të qartësojë kompetencat e tyre.
- Fuqizojë rolin dhe rritur mundësimin e grupeve të interesit nga shoqëria civile për t’u konsultuar dhe marrë pjesë në ofrimin e shërbimeve për shmangien e dhunës dhe korrigjimin e pasojave të vijnë prej saj.
- Përkufizojë në mënyrë më të qartë dhe shteruese konceptet e lidhura me dhunën, diskriminimin dhe llojet e tij, llojet e ndryshme të dhunës të cilat futen për herë të parë në kornizën ligjore shqiptare;
- Të sigurojë zbatimin e parimit të mosdiskriminimit, të mbrojtjes nga dhuna, nga ngacmimi dhe ngacmimi seksual si në sektorin publik ashtu edhe privat.
- Të zgjerojë fushat dhe sektorët ku do të gjejë zbatim dhe sigurohen parimet e sipërpërmendura (përfshirë punësimin, mbrojtjen sociale, teknologjinë, median, etj)
- Përfshijë rregulla më të qarta dhe forcojë mekanizmin e përfshirë në strukturat dhe organet që kanë kompetencën për të menaxhuar konfliktet me bazë diskriminimin, dhunën ndaj grave dhe ngacmimin, në familje, punë, shoqëri, etj;

- Integrojë buxhetimin në të gjitha politikat publike dhe vendimmarrjet qeveritare ku të parashikohet mbështetja e dedikuar për qendrat, organizatat e shoqërisë civile që luajnë rolin e tyre në procesin e mbrojtjes nga diskriminimi dhe dhuna në familje e më gjerë.
- Mundësojë një politikë për përpunimin e të dhënave dhe krijimin e instrumenteve të nevojshëm për të matur gjendjen aktuale, të grave dhe vajzave të përfshira në procese dhune dhe ngacmime.

Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.

Në SKBGJ 2021-2030 parashikohet në mënyrë gjithëpërfshirëse vizioni i strategjisë, qëllimet e politikës, objektivat specifike për secilin qëllim dhe masat e nevojshme për arritjen e secilit objektiv. Dokumenti parashikon gjithashtu treguesit kryesorë të performancës, me qëllim matjen e arritjeve dhe progresit për secilin prej objektivave specifike. Në terma të masave të propozuara në këtë dokument strategjik, synohet edhe rishikimi i ligjit nr.9669/2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar, me qëllim reflektimin e të gjitha ndryshimeve që kanë ndodhur pas vitit 2020 në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar me fokus çështje të mbrojtjes nga dhuna, ngacmimi dhe diskriminimi me bazë gjinore dhe problematikat dhe nevojat e evidentuara gjatë periudhës së zbatimit të legjislacionit në fuqi.

Dalja e ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje plotëson më mirë bazën ligjore të ndryshuar dhe miratuar. Gjatë periudhës 2016 – 2020 janë miratuar apo përmirësuar edhe një sërë ligjesh të tjera, ku është theksuar parimi i barazisë gjinore apo mbrojtja nga dhuna dhe diskriminimi.

Kjo nismë është parashikuar si një nga masat e Strategjisë Kombëtare për Barazinë gjinore 2021-2030, që parashikon se zbatimi i kuadrit ligjor si dhe përmirësimi i disa aspekteve të tjera të tij në përputhje dhe me rekomandimet e dhëna nga institucionet ndërkombëtare, do t’u hapë rrugën një tërësie veprimesh të tjera të planifikuara, për të mundësuar arritjen e rezultateve të dëshiruara, të cilat synojnë avancimin drejt një shoqërie të lirë nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje.

Në Strategjinë Kombëtare për Barazinë gjinore 2021-2030 nënvizohet qëllimet që: *gratë e vajzat të jetojnë të lirë nga praktikat e dëmshme dhe dhuna; si dhe ku grupet e cënueshme trajtohen me përparësi dhe mbështeten derisa të fuqizohen e gëzojnë të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës - pra një shoqëri ku dhuna nuk tolerohet dhe ku garantohen masat e mbështetjes dhe mbrojtjes ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.*

Kjo ndërhyrje mbështet objektivat strategjike të qeverisë shqiptare në disa aspekte kyçe:

Së pari, nisma është në përputhje me vizionin e Qeverisë shqiptare dhe në përmbushje të prioriteteve të shpallura në Programin Politik Qeverisës 2021-2025,² dhe posaçërisht me pjesën “Familja” në të cilën parashikohet angazhimi për politika që rrisin “... strehimin e ... grave e vajzave, duke rritur njëkohësisht në sasi e cilësi të gjitha shërbimet e shtetit për familjet”,³ si dhe zgjerimi i “.. qendrave dhe shërbimeve të reja në territor për ... gratë në nevojë në të gjitha bashkitë e vendit si dhe do të mbështetet krijimi i 11 ndërmarrjeve sociale me qëllim mbështetjen e grave dhe vajzave..”⁴

Së dyti, nisma lidhet drejtpërdrejtë me masat për përfshirjen sociale në zbatim të objektivave dhe masave të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2030 të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 88, datë 22.2.2023 “Për miratimin e strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030”. Në SKZHIE, vizioni i barazisë gjinore “mbështetet në parimin e tolerancës zero ndaj praktikave të dëmshme, dhunës me

² https://kryeministria.al/ep-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf.

³ Po aty, fq. 28.

⁴ Po aty, fq. 33.

bazë gjinore dhe dhunës në familje, ndëshkimit të autorëve dhe mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e personave të dhunuar”.⁵

Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si institucioni kryesor përgjegjës që ushtron rol drejtues në hartimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave të integruara, të programeve kombëtare dhe vlerëson burimet financiare dhe njerëzore të nevojshme për parandalimin, mbrojtjen e viktimave, llojshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve mbështetëse të përgjithshme dhe të specializuara; mban peshën kryesore lidhur me monitorimin e zbatimit të masave të parashikuara në këtë dokument strategjik. Megjithatë, për masa specifike të cilat përcaktojnë institucione të tjera përgjegjëse lidhur me zbatimin, MSHMS do të analizojë informacionin e përcjellë nga këto të fundit referuar statusit dhe nivelit të realizimit të masave specifike.

Së treti, nisma është në përputhje me Planin Kombëtar të Integritimit Evropian (PKIE) të miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 16, datë 11.1.2024 “Për miratimin e planit kombëtar për integritimin evropian 2024–2026” dhe PKIE 2025-2027.”.

Së katërti, nisma është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore, 2021-2030 ku parashikohet në mënyrë gjithëpërfshirëse vizioni i strategjisë, qëllimet e politikës, objektivat specifike për secilin qëllim dhe masat e nevojshme për arritjen e secilit objektiv, ku parashikohet edhe mbrojtja e grave nga dhuna si një komponent i rëndësishëm i respektimit të mosdiskriminimit me bazë gjinore

Së pesti, nisma është në përputhje me vizionin qeverisës në kuadër të zbatimit të Agjendës Kombëtare të Reformës Qeveritare e cila synon të zbatohet sipas politikave të shëndosha dhe kuadrit ligjor, si dhe mekanizmave dhe instrumenteve që sigurojnë integritimin gjinor dhe mundësitë e barabarta.⁶

Së fundmi, procesi i hartimit të ndryshimeve të ligjit ka qenë i parashikuar në programin analitik të planifikimit të projekt akteve nga MSHMS dhe Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës.

Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.

Mbrojtja e grave nga diskriminimi dhe dhuna është një nga objektivat e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim Evropian 2022–2030 (SKZHIE) dhe ndërhyrjet specifike kontribuojnë në arritjen e Objektive të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), si dhe në Agjendën e OKB-së 2030. Të gjitha ministratë e linjës dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë marrë masa dhe planifikojnë vazhdimisht ndërhyrje për përmbushjen e objektive të këtyre dy strategjive të rëndësishme, në bashkëpunim me partnerët zhvillimorë, organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare.

Masa të tjera të ndërmarra tashmë në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje përfshijnë:

Në mënyrë të veçantë për çështjet e dhunës në familje dhe mosdiskriminimit qëllimi i ligjit është që të parandalojë dhe zvogëlojë dhunën në familje në të gjitha format e saj dhe të mbrojë viktimat përmes një procedure të shpejtë, të përballeshme dhe të thjeshtë. Dy përmirësimet më të rëndësishme të këtij ligji datojnë në vitet 2018 dhe 2020. Ligji 47/2018 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, përmbushi rekomandimet e dhëna nga Komiteti CEDAE (2016) dhe nga GREVIO (2017). Nëpërmjet ndryshimeve të bëra, u forcuan masat mbrojtëse dhe proceduriale për një përgjigje më efektive ndaj dhunës në familje dhe mbrojtja e viktimave, përmes lëshimit të Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme, i paraprirë nga vlerësimi i riskut, për çdo rast që trajtohet.

- Ligji 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” ku parimi i mosdiskriminimit për një tërësi shkaqesh, duke filluar nga gjinia, renditet në parimet bazë;
- Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, ku barazia dhe mosdiskriminimi përmenden që në parimet e përgjithshme të tij;
- Ligji 37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur” që garanton një kornizë ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës viktimë dhe/ose dëshmitar i veprës penale dhe parandalon ri-viktimizimin/viktimizimin dytësor të fëmijës që ka qenë më parë viktimë e një veprë penale;

⁵ <https://qbz.gov.al/share/3VxOqmLUSëOëhi00jsdZUG>

⁶ <https://ëëë.drejtësia.gov.al/ëp-content/uploads/2024/11/Dokument-Politik-Agjenda-Kombetare-e-Reformave-2024-2027.pdf>

- Ligji 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, që ndër të tjera garanton ndihmë juridike falas për kategori të veçanta: viktimat e dhunës në familje, abuzimit seksual, persona, të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, etj;
- Ligji 22/2018 “Për strehimin social”, ku theksohet parimi i mosdiskriminimit, për grupet sociale në nevojë për strehim, viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe vajzat nëna;
- Ligji 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” ku përcaktohen si përfituese/përfitues të ndihmës ekonomike ndër të tjera viktimat e trafikimit, si dhe viktimat e dhunës në familje, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të cilat nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- Ligji nr. 75/2019 “Për rininë”, që parashikon fuqizimin e të rejave/rinjve në parimet e të mosdiskriminimit, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara.
- Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” është i përafuar me aktet e BE-së dhe bazohet në parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit⁷.
- Zbatimi i rekomandimeve të GREVIO dhe CEDAE, duke mundësuar miratimin e ndryshimeve në ligjin kundër dhunës në familje, plotësimin e kuadrit nënligjor dhe ndryshimeve në Kodin Penal për forcimin e mbrojtjes ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.
- Integrimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor (BPGJ) në politikat publike:
- Përqindja e totalit të shpenzimeve buxhetore për çështjet me bazë gjinore në përgjithësi, është rritur nga 2.3% në 2017 në pothuajse 10% për periudhën 2022–2024.
- Fushata ndërgjegjësuere dhe edukative për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe promovimin e barazisë gjinore, të zhvilluara nga institucione si Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, bashkitë, organizatat.
 - Trajnime dhe programe për rritjen e kapaciteteve për punonjësit e institucioneve publike, policisë, shërbimeve sociale dhe sistemit gjyqësor, për të përmirësuar reagimin ndaj rasteve të dhunës.
 - Krijimi dhe forcimi i mekanizmave vendorë të referimit për rastet e dhunës në familje, që sigurojnë bashkërendim ndërmjet policisë, shërbimeve sociale, institucioneve shëndetësore dhe organizatave joqeveritare.
 - Zgjerimi i rrjetit të strehëzave dhe qendrave të emergjencës për gratë dhe fëmijët viktimat e dhunës, si dhe ofrimi i shërbimeve psikosociale, juridike dhe rehabilituese.
 - Mbledhja dhe analizimi i të dhënave statistikore mbi rastet e dhunës, përmirësimi i sistemit të raportimit dhe monitorimit për të ndërtuar politika të bazuara në evidenca.
 - Bashkëpunimi me organizata joqeveritare dhe agjenci ndërkombëtare (p.sh. UN Women, UNDP, OSBE) për zbatimin e programeve të përbashkëta kundër dhunës me bazë gjinore.
 - Përfshirja e edukimit gjinor dhe të drejtave të njeriut në programe shkollore dhe universitare, për të ndikuar në ndryshimin e qëndrimeve dhe stereotipeve gjinore në shoqëri.

Këto hapa tregojnë një progres të qëndrueshëm në garantimin e mbrojtjes ndaj grave dhe vajzave në familje dhe shoqëri në Shqipëri, por gjithashtu evidentojnë nevojën për një kuadër të ri ligjor të përditësuar, i cili do të sigurojë harmonizimin e plotë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Objektivi i politikës

1. *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij*
2. *Është Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
3. *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Politika që synohet të zhvillohet përmes kësaj ndërhyrje ligjore ka disa objektiva strategjikë:

⁷ Ligji nr. 124/2020, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010, ‘Për mbrojtjen nga diskriminimi’”.

13. Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me direktivat e BE-së dhe standardet ndërkombëtare mbi luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, dhe të drejtat e njeriut brenda vitit 2026. (të përcaktohet nga drejtoria)
1. Forcimi i mekanizmave dhe instrumentave për zbatimin e mbrojtjes nga dhuna në marrëdhëniet familjare dhe më gjerë brenda vitit. (të përcaktohet afat nga MSHMS)
2. Fuqizimi i rolit të grupeve të interesit nga shoqëria civile për të marrë pjesë në ofrimin e shërbimeve për shmangien e dhunës në familje, në vendin e punës, etj dhe korrigjimin e pasojave të vijnë prej saj.
3. Garantimi i mbrojtjes nga dhuna e mosdiskriminimi, nga ngacmimi dhe ngacmimi seksual, si në sektorin publik ashtu edhe në sektorin privat. Integrimi i buxhetimit gjinor në të gjitha politikat publike dhe proceset vendimmarrëse qeveritare, duke garantuar mbështetje të dedikuara financiare për qendrat dhe organizatat e shoqërisë civile që kontribuojnë në parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe dhuna në familje.
4. Krijimi i mekanizmave të posaçëm për përpunimin e të dhënave dhe krijimin e instrumenteve të matjes dhe monitorimit, me qëllim vlerësimin e gjendjes aktuale të grave dhe vajzave të përfshira në raste dhune dhe ngacmimi, si bazë për politika të efektshme parandaluese dhe mbrojtëse.
5. *Zgjerimi i mbrojtjes përtej sferës familjare, duke përfshirë mjedisin publik, privat dhe digjital'*
6. *Garantimi i aksesit falas, të shpejtë dhe të thjeshtuar për viktimat në gjykata dhe mekanizma të tjerë administrativë.*
Krijimi dhe funksionalizimi i rrjetit të koordinuar të referimit në nivel qendror dhe vendor.
7. *Qartësimi i roleve dhe detyrimeve të autoriteteve publike dhe subjekteve private.*
8. *Forcimi i bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe institucionet e të drejtave të njeriut.*
9. *Sigurimi i shërbimeve 24/7, strehimit emergjent, ndihmës psikosociale, juridike dhe ekonomike.*
10. *Krijimi i standardeve të unifikuara të shërbimeve dhe rritja e kapaciteteve të punonjësve.*
11. *Rehabilitimi dhe riintegrimi i viktimave dhe sipas rastit, programe të detyrueshme për autorët.*

Objektivat e mëposhtëm specifikë përfaqësojnë drejtimit kryesore të ndikimit që pritet të gjenerojë nisma e propozuar:

1. Harmonizimi i kuadrit ligjor dhe nënligjor, me ligjin për barazinë gjinore dhe direktivat përkatëse të BE-së deri në vitin 2030.
2. Integrimi i të dhënave të analizës së situatës aktuale dhe perspektivave të dhunës ndaj grave në të gjitha politikat sektoriale përkatëse, duke zhvilluar raporte vjetore dhe rekomandime konkrete, deri në vitin 2028.
3. Institucionalizimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të paktën 10 institucione publike (ministri, struktura vartëse dhe bashki) me qëllim forcimin e mekanizmave mbrojtës dhe rritjen e funksionimit të qendrave të mbrojtjes nga dhuna, deri në vitin 2030.
4. Sigurimi i mbështetjes financiare për të paktën 1500 gra dhe vajza të dhunuara deri në vitin 2030, duke përfshirë akses në skema punësimi dhe strehim social sipas nevojave individuale.
5. Miratimi i politikave për rritjen e ekuilibrit punë-jetë, në të gjitha institucionet publike dhe sektoret kryesore, duke përfshirë masa fleksibile dhe mekanizma mbrojtës, deri në vitin 2027, me qëllim zbutjen e pasojave të dhunës në familje dhe ngacmimit në vendin e punës.
6. Organizimi i një fushate kombëtare vjetore për ndërgjegjësimin mbi format e dhunës dhe të drejtat e grave në familje, në ambientin e punës, me qëllim referimin e rasteve të dhunës dhe adresimin e zgjidhjes së pasojave jo vetëm në qytete, por edhe në zonat rurale dhe komunitetet e marginalizuara, duke

mbuluar të paktën 61 bashki deri në vitin 2030, me matjen e rezultateve përmes numrit të pjesëmarrësve dhe rasteve të referuara për adresim.

7. Përfshirja e moduleve mbi mbrojtjen nga dhuna, diskriminimi dhe të drejtat e njeriut në kurrikulat në të gjitha kurrikulat parauniversitare dhe universitare, duke synuar të paktën X% e shkollave dhe universiteteve deri në vitin 2027.
8. Funksionalizimi i mekanizmave të integruar për mbledhjen, analizimin dhe publikimin e të dhënave të ndara mbi rastet e dhunës në familje dhe më gjerë, duke përmirësuar sistemin e monitorimit dhe raportimit, deri në vitin 2026.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*

Për të përcaktuar opsionin më të mirë për zgjidhjen e problematikave të mësipërme janë marrë në shqyrtim opsionet e mëposhtme:

Opsioni 0 (Ruajtja e Status-quo-së): Të vijohet me kuadrin ligjor ekzistues, duke pritur që situata të vetërregullohet.

Ligji aktual është hartuar në vitin 2006 dhe ka pësuar ndryshime (me ligjin nr. 9914, datë 12.5.2008, nr. 10 329, datë 30.9.2010, nr. 47/2018, datë 23.7.2018, nr. 125/2020, datë 15.10.2020). Ky opsion nuk adreson problematikat aktuale që lidhen me dhunën ndaj grave duke qënë se ligji rregullon vetëm dhunën në marrëdhënit familjare. Gjithashtu, kërkohet, që lidhen me harmonizimin e legjislacionit të dhunës ndaj grave me ndryshimet kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe me ndryshimet shoqërore të pësura përgjatë kësaj periudhe.

Avantazhet: Nuk ka kosto shtesë për qeverinë.

Disavantazhet: Nuk i përgjigjet zhvillimeve të reja vecanërisht formave të dhunës digjitale, dhunës e ngacmimit në vendet e punës, etj; nuk mundëson një qasje të përditësuar dhe gjithëpërfshirëse për mbrojtjen nga të gjitha format e dhunës në familje e më gjerë; mund të krijojë boshllëqe ligjore dhe moszbatim efektiv.

Opsioni 2 (rregullator): Ndërhyrje të targetuara në aktet ligjore sektoriale

Ky opsion konsiston në ndërhyrje të pjesshme dhe të koordinuara në një sërë aktesh ligjore sektoriale ekzistuese, me synim përmirësimin e dispozitave që lidhen me mbrojtjen nga dhuna në familje dhe diskriminimi, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë në fushën e të drejtave të njeriut. Qasja e parashikuar nënkupton harmonizimin gradual të legjislacionit përmes amendimeve në ligje të veçanta që rregullojnë fusha kyçe të jetës publike, ekonomike dhe institucionale.

Ndër ligjet ku parashikohet të realizohen këto ndërhyrje përfshihen:

- **Kodi i Punës**, ku synohet forcimi i dispozitave që ndalojnë diskriminimin në punësim dhe dhunën në ambientin e punës, mbrojtjen nga ngacmimi dhe ngacmimi seksual, etj.
- **Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi**, ku do të rishikohen kompetencat e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke e pajisur me instrumente më efektive për trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave, si dhe duke harmonizuar dispozitat me praktikën më të mira të BE-së për barrën e provës dhe sanksionet administrative.
- **Kodi i Familjes**, ku ndërhyrjet do të fokusohen në marrëdhëniet e kujdestarisë dhe në ato që lidhen me të drejtën prindërore për rastet kur fëmijët janë viktimë dhe dëshmitarë të dhunës së ushtruar në familje, duke evidentuar rastet kur dhuna ushtrohet nga anëtarë të familjes, ose ndonjëri nga prindërit apo kujdestarët;.
- **Ligji për Avokatin e Popullit**, ku do të përcaktohen më qartë kompetencat e institucionit për të mbikëqyrur zbatimin e të drejtave të viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje dhe për të bashkëvepruar me institucionet përkatëse për rastet e shkeljes nga diskriminimi dhe dhuna ndaj grave.
- **Ligji për asistencën sociale** ku do të përcaktohen si përfituese/përfitues të ndihmës ekonomike ndër të tjera edhe viktimat e dhunës ndaj grave në format e reja të propozara nga ky draft, krahas viktimave të dhunës në familje, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, të cilat nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore;

- **Ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti**, që ndër të tjera garanton ndihmë juridike falas për kategori të veçanta: viktimat të dhunës në familje, abuzimit seksual, persona, të cilëve u është cënuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, etj;
- **Ligji “Për strehimin social”**, ku do të theksohet parimi i mosdiskriminimit, për grupet sociale në nevojë për strehim, viktimat e trafikimit, dhunës në familje dhe vajzat nëna;
- Ligje të tjera sektoriale si **ligji për arsimin e parashkollor edhe ai për arsimin e lartë, për punësimin dhe aftësimin profesional**, Ligji “Për rininë”, Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Ligji për shërbimet e kujdesit shoqëror, do të mund të përfshijnë dispozita që synojnë garantimin e shërbimeve mbështetëse të përgjithshme dhe të specializuara.

Avantazhet e këtij opsioni përfshijnë:

- Qasje graduale dhe fleksibile: Lejon zbatimin e ndërhyrjeve në mënyrë të shtrirë në kohë, duke mos e ngarkuar menjëherë sistemin ligjor me një reformë të thellë të vetme.
- Redukton rezistencën institucionale dhe politike: Ndryshimet në ligje ekzistuese janë më të lehta për t'u pranuar nga institucionet dhe aktorët që mund të kundërshtojnë një ligj tërësor.
- Shfrytëzon kuadrin ekzistues ligjor dhe institucional: Parandalon krijimin e strukturave të reja dhe mbështetet në ato ekzistuese, duke përdorur rrjetet e tanishme të zbatimit dhe monitorimit.
- Mundëson ndërhyrje të shpejta në fusha me boshllëqe evidente: Për shembull, për përmirësimin e mbrojtjes kundër ngacmimit, dhunës dixhitale, dhunës dhe ngacmimit në punë, etj.
- Afrohet drejt standardeve të BE-së: Lejon harmonizimin e drejtpërdrejtë të legjislacionit sektorial me direktiva të veçanta të Bashkimit Evropian.

Disavantazhet:

- Kuadër ligjor i fragmentuar dhe jo-koherent: Dispozitat për dhunën ndaj grave do të shpërndahen në ligje të ndryshme, duke vështirësuar zbatimin e koordinuar dhe monitorimin sistematik të progresit. Kjo krijon paqartësi si ligjore dhe mungesë kuptueshmërie për publikun.
- Kohëzgjatje e lartë për miratimin dhe zbatimin: Procesi i ndryshimit të shumë ligjeve kërkon kohë të konsiderueshme dhe përfshirje të gjerë të aktorëve institucionalë dhe parlamentarë.
- Kosto të shpërndara dhe të paqarta: Çdo ndryshim ligjor mund të ketë nevojë të veçanta për burime financiare (trajnime, sistemet e të dhënave, mbikëqyrje), duke e bërë më të vështirë planifikimin buxhetor të integruar.
- Mungesë mekanizmi unik të llogaridhënies: Mungesa e një ligji kornizë e bën të vështirë vendosjen e përgjegjësi të qarta ndër-institucionale dhe ndërtimin e një zinxhiri të vetëm të llogaridhënies.
- Zbatim i kufizuar ose thuajse i pamundur në sektorin privat: Ligjet sektoriale shpesh nuk mbulojnë në mënyrë të mjaftueshme fushën e veprimit duke lënë boshllëqe në zbatimin e standardeve për mbrojtjen e grave nga dhuna dhe diskriminimi.

Opsioni 3 (rregullator): Bërja e ndryshimeve në ligjin 9669/2018 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, i ndryshuar.

Ky opsion përfshin amendimin e ligjit të vitit 2018 për të reflektuar zhvillimet e reja. Edhe ky opsion ka disa avantazhe dhe disavantazhe të analizuara si më poshtë:

Avantazhet:

- Mundësia për të arritur objektiva dhe zgjidhur probleme specifike: Ky opsion mund të ndihmojë në adresimin e shumë problemeve dhe nevojave për përmirësim të ligjit ekzistues, duke ofruar një qasje të drejtpërdrejtë dhe efektive për të përmirësuar elementet e caktuara të ligjit që kanë mbetur të paplotësuara ose të papërshtatshme për situatat aktuale.
- Rikonsiderim i zhvillimeve të reja dhe harmonizim i legjislacionit: Me amendimin e ligjit të vitit 2018, mund të përfshihen zhvillimet e fundit ligjore dhe angazhimet ndërkombëtare për mbrojtjen nga dhuna e

diskriminimi dhe të drejtat e individëve, duke e përputhur ligjin me praktikat më të fundit të BE-së dhe normat ndërkombëtare.

- Kosto më e ulët dhe procedurë më e shpejtë për ndryshimet teknike: Ndryshimet e detajuara dhe të targetuara në dispozitat ekzistuese kërkojnë më pak kohë dhe burime krahasuar me hartimin e një ligji të ri nga e para. Kjo mund të kontribuojë në shpejtimin e procesit të ndryshimeve ligjore (ndryshimet e kërkuara dhe adresimi i problematikave të bëhen të mundura në një kohë sa më të shkurtër) dhe të reduktojë ndjeshëm kostot për shtetin.
- Lehtësi në monitorim dhe zbatim: Një ligj ekzistues ka një strukturë të vendosur dhe mekanizma për referimin e rasteve të dhunës apo menaxhimit e pasojave të saj, ka një mekanizma monitorimi të njohur, që mund të përdoren për të monitoruar zbatimin e ndryshimeve të reja, duke përfshirë mbikëqyrjen e efekteve të mundshme të amendimeve të reja.

Ndërkohë, në terma të **disavantazheve**, lidhur me Opsionin 3 vlen të përmendim:

- Kufizimi i mundësive për një qasje gjithëpërfshirëse: Ky opsion ka të bëjë vetëm me përmirësime të pjesshme dhe amendime të legjislacionit ekzistues. Ndryshimi i një ligji ekzistues mund të ketë kufizime në nivelin e ndryshimeve që mund të bëhen. Mbi të gjitha, nëse ligji ekzistues ka një strukturë të brendshme që nuk përputhet me të gjitha ndryshimet që kanë ndodhur ndërkohë dhe rekomandimet ndërkombëtare, mund të jetë shumë e vështirë të sigurohet një përfshirje e plotë e të gjitha aspekteve të mbrojtjes së grave e vajzave nga dhuna dhe diskriminimi dhe të drejtat e individëve.
- Teknika legjislative: Nëse ndryshimet prekin thelbin e ligjit ekzistues ose më shumë se 50% të dispozitave të tij, është e rekomanduar të hartohet një akt i ri ligjor për të siguruar qartësinë dhe koherencën e aktit. Kjo ka të bëjë me rëndësinë që ka qartësia e aktit ligjor dhe konsistencën e tij për t'u kuptuar dhe zbatuar nga qytetarët, institucione dhe aktorë të tjerë. Kjo mund të kërkojë një kohë të gjatë dhe mund të krijojë pasiguri nëse ligji ekzistues është ndryshuar ndjeshëm, pa mundësinë për të krijuar një akt të ri dhe më të përshtatshëm për realitetin e tanishëm.
- Fragmentimi i qasjes për parandalimin dhe mbrojtjen e grave nga dhuna: Për shkak se ky opsion përfshin vetëm ndryshime të pjesshme, mund të krijohet një kuadër ligjor i fragmentuar dhe jo koherent që nuk i adreson të gjitha aspektet e dhunës ndaj grave në familje, punë, politikë e shoqëri. Ajo mund të mbetet shumë specifike dhe të ndihmojë vetëm në disa aspekte të problemit, duke lënë boshllëqe për pjesë të tjera që janë të rëndësishme për përfshirjen e plotë mbrojtjes nga dhuna e diskriminimi në jetën e përditshme.
- Ndikim i kufizuar në sektorin privat dhe shoqërinë civile: Pavarësisht se ndryshimi i ligjit mund të sjellë përmirësime në sektorët e administratës publike dhe të drejtat e punonjësve, ai mund të ketë ndikim të kufizuar në sektorin privat dhe në mundësinë e adresimit të diskriminimit e dhunës ndaj grave, ku legjislacioni mund të jetë më pak i rreptë.

Në këtë kontekst, edhe pse amendimi i ligjit ekzistues mund të ofrojë një mundësi të shpejtë dhe efektive për adresimin e disa çështjeve të mbrojtjes së grave nga dhuna dhe diskriminimi, ky opsion ka disa kufizime të mëdha lidhur me mundësinë për të siguruar një qasje të gjithëpërfshirëse dhe për të trajtuar të gjitha aspektet e nevojshme. Po ashtu, ndonëse ndihmon në adresimin e disa problemeve, kjo mund të jetë e mjaftueshme vetëm për disa fusha, por mund të kërkojë ndryshime më të thella dhe një ligj të ri për të siguruar një kuadër të plotë dhe koherent për mbrojtjen e grave dhe vajzave nga diskriminimi, dhuna dhe ngacmimi në familje dhe më gjerë.

Opsioni 4 (i preferuar) rregullator: Hartimi i një ligji të ri për mbrojtjen e grave nga dhuna dhe diskriminimi.

Ky opsion lejon hartimin e një kuadri rregullator të ri dhe gjithëpërfshirës që pasqyron të gjitha aspektet e mbrojtjes së grave dhe vajzave nga diskriminimi, dhuna dhe ngacmimi në familje dhe më gjerë.

Avantazhet:

Qasje gjithëpërfshirëse dhe e plotë: Hartimi i një ligji të ri mundëson përfshirjen e të gjitha aspekteve e formave të dhunës ku një pjesë e konsiderueshme trajtohet në herë të parë në kuadrin ligjor shqiptar, duke siguruar që ligji të pasqyrojë ndryshimet e nevojshme sociale dhe ndërkombëtare, si dhe të adresojë në mënyrë gjithëpërfshirëse çdo formë diskriminimi, ngacmimi dhe dhune, pa kufizime strukturore të një ligji ekzistues.

Teknika legislative e përmirësuar: Hartimi i një akti të ri ligjor mund të sigurojë qartësi dhe koherencë, duke eliminuar pasigurinë që mund të krijohet nga ndryshimet e mëdha në një ligj ekzistues. Një ligj i ri mund të jetë më i përshtatshëm dhe i kuptueshëm për qytetarët, institucione dhe aktorët e tjerë, duke siguruar zbatim më të efektshëm dhe pa kontradikta në dispozitat e tij.

Koherencë dhe integritet i plotë i masave për mbrojtjen e grave dhe vajzave nga dhuna, diskriminimi dhe ngacmimi në familje dhe më gjerë.

Hartimi i një ligji të ri mund të sigurojë një kuadër ligjor të integruar dhe koherent, duke mundësuar adresimin e të gjitha aspekteve të dhunës në familje e shoqëri në mënyrë të qëndrueshme dhe të plotë, pa lënë boshllëqe dhe duke siguruar një qasje të konsoliduar.

Ndikim më të gjerë në sektorin privat dhe shoqërinë civile: Një ligj i ri mund të përfshijë rregullore të qarta për sektorin privat dhe shoqërinë civile, duke adresuar diskriminimin, dhunën dhe ngacmimin dhe promovuar mbrojtjen e grave në të gjithë shoqërinë, përfshirë edhe bizneset private dhe organizatat që nuk janë të përfshira plotësisht në ligjet ekzistuese. Kjo mund të çojë në një ndikim më të madh dhe më të qëndrueshëm në të gjithë shoqërinë.

Disavantazhet: Ka një kosto fillestare më të lartë për qeverinë dhe kërkon një angazhim të fortë politik dhe administrativ për zbatimin e tij. Gjithashtu kërkon më shumë kohë dhe burime njerëzore për adresimin e problematikave. Aktorët e përfshirë mund të kërkojnë më shumë kohë, për t'u përshtatur me një ligj të ri dhe me mekanizmat e vendosur prej tij, etj.

Opsioni 5: Jo rregullator: Ndërhyrje përmes masave rregullatore

Ky opsion konsiston në ndërmarrjen e masave jo-rregullatore, pra ndërhyrjeve që nuk kërkojnë ndryshime të drejtpërdrejta në legjislacionin ekzistues, por që synojnë adresimin e problemeve të identifikuara dhe përmbushjen e objektivave të caktuara përmes veprimeve praktike, administrative, komunikative ose institucionale.

Masa të tilla mund të përfshijnë:

- Organizimin e fushatave sensibilizuese kombëtare dhe lokale, që promovojnë mbrojtjen e grave dhe vajzave nga diskriminimi, dhuna dhe ngacmimi në familje dhe më gjerë, në familje, punësim, media dhe shoqëri në tërësi;
- Aktivitete trajnimi dhe ngritje kapacitetesh për punonjësit e administratës publike, bizneset, ofruesit e drejtësisë dhe shoqërinë civile në lidhje me mbrojtjen e grave dhe vajzave nga diskriminimi, dhuna dhe ngacmimi në familje dhe më gjerë dhe zbatimin e qasjes me tolerancë zero ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në politikat publike;
- Zbatimin e kontrolleve administrative, inspektimeve apo mekanizmave të mbikëqyrjes që nuk kërkojnë amendime të ligjit, por bazohen në kompetencat ekzistuese të institucioneve përkatëse;
- Përfshirjen e instrumenteve të politikave publike si udhëzues praktikë, dokumente politike, plane veprimi sektoriale ose mekanizma të vullnetshëm të vetërregullimit (p.sh. kode etike ose rregullore të brendshme në institucione publike dhe subjekte private);
- Zbatimin e masave ndër-institucionale koordinuese, si krijimi i grupeve të punës, platformave ose forumeve të përbashkëta të partneritetit me sektorin privat dhe OJF-të.

Avantazhet e opsionit jo-rregullator

- Zbatim më i shpejtë në kohë – Masat jo-rregullatore mund të ndërmerren pa kaluar nëpër procedura legislative të gjata dhe burokratike, duke siguruar reaksione të menjëhershme ndaj problematikave të konstatuara.
- Kosto më të ulëta – Duke shmangur procesin e hartimit, konsultimit dhe miratimit të ndryshimeve ligjore, ky opsion kursen burime financiare dhe administrative, veçanërisht nëse mbështetet në burime ekzistuese ose partneritete ndër-institucionale.
- Zhvillimi i një kulture të re institucionale dhe shoqërore – Ndërgjegjësimi publik dhe edukimi kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje mund të sjellin ndryshime të qëndrueshme në sjellje, norma dhe praktika

sociale, duke ndikuar thellësisht në perceptimet për subjektet e përfshira në skenarë të dhunës dhe ngacmimit në familje dhe shoqëri.

- Mbështetje për zbatimin e politikave ekzistuese – Masat jo-rregullatore mund të shërbejnë si instrumente ndihmëse për forcimin e kuadrit aktual ligjor, përmes zbatimit efektiv të detyrimeve ekzistuese dhe nxitjes së pajtueshmërisë vullnetare në sektorin privat.

Ndërkohë, disavantazhet e opsionit jo-rregullator lidhen me:

- Nuk mundëson harmonizimin me acquis të BE-së – Ky opsion nuk e përmbush kërkesën për përputhje ligjore me direktivat e Bashkimit Evropian, të cilat kërkojnë dispozita konkrete dhe të detyrueshme në legjislacionin kombëtar.
- Nuk sjell ndryshime normative të detyrueshme – Pa ndryshime ligjore, masat e ndërmarra nuk kanë fuqi detyruese dhe varen kryesisht nga vullneti politik ose institucional i zbatuesve përkatës.
- Ndikim i kufizuar strukturor dhe institucional – Ky opsion nuk krijon mekanizma të rinj institucionalë dhe nuk përforcon kapacitetet ligjore për mbrojtjen nga dhuna dhe diskriminimi, ndaj nuk e garanton krijimin e një sistemi të qëndrueshëm llogaridhënës.
- Vështirësi në matjen e ndikimit dhe rezultateve – Masat jo-rregullatore shpesh kanë vështirësi në krijimin e indikatorëve objektivë për matjen e suksesit dhe ndërlidhen më tepër me ndryshime të buta (soft laë), të cilat janë më të vështira për t'u standardizuar apo vlerësuar në mënyrë të njëtrajtshme.

Sa më sipër, opsioni jo-rregullator mund të jetë **një shtesë e rëndësishme dhe plotësuese ndaj ndërhyrjeve ligjore**, veçanërisht për ndërgjegjësim, edukim dhe zbatim praktik. Megjithatë, ai **nuk mund të konsiderohet alternativë e mjaftueshme**, nëse synimi është arritja e një **kuadri të harmonizuar ligjor dhe të detyrueshëm për mbrojtjen nga dhuna në familje, nga diskriminimi dhe ngacmimi i grave në familje dhe shoqëri**, në përputhje me standardet e BE-së dhe angazhimet ndërkombëtare të Shqipërisë.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

1. *Identifikoni grupet e prekura.*
2. *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
3. *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - a. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - b. *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - c. *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
 - d. *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
4. *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - a. *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - b. *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
5. *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - a. *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - b. *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
6. *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - a. *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - b. *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*
 - c. *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Në analizën e opsioneve për rregullimin dhe përmirësimin e situatës së dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, grupet e prekura janë të shumta dhe përfshijnë aktorë të ndryshëm që mund të ndikohen drejtpërdrejt ose në mënyrë

jo të drejtpërdrejtë nga ndryshimet ligjore që implikon opsioni i preferuar. Këtu janë disa nga grupet kryesore të prekura:

a) Gratë dhe vajzat

- Nisma synon parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje duke i kushtuar vëmendje të veçantë grupeve të cënueshme. “Dhunë ndaj grave” është çdo akt dhune i drejtuar kundër një gruaje ose vajze që ndikon në mënyrë disproporcionale te gratë ose vajzat, dhe është një formë diskriminimi kundër grave, që sjell ose ka gjasa të sjellë dëme ose vuajtje fizike, seksuale, psikologjike ose ekonomike, përfshirë kërcënimet për veprime të tilla, shtrëngimin ose privimin arbitrar të lirisë, pavarësisht nëse ndodhin në jetën publike, private përfshirë dhunën e lehtësuara nga teknologjia. Grupet e prekura brenda kësaj kategorie përfshijnë:

- Gratë dhe vajzat viktimë të dhunës fizike
- Gratë dhe vajzat viktimë të dhunës psikologjike,
- Gratë dhe vajzat viktimë të dhunës dhe ngacmimit seksual
- Gratë dhe vajzat viktimë të dhunës së lehtësuar nga teknologjia
- Gratë dhe vajzat në politikë

Ndikime të drejtpërdrejta për gratë dhe vajzat

Cilësore

- Përmirësimi i mbrojtjes ligjore për të gjitha format e dhunës (fizike, psikologjike, ekonomike, seksuale, digjitale, politike).
- Qasje më e shpejtë në drejtësi përmes urdhrave të menjëhershëm dhe mekanizmave të thjeshtuar të raportimit.
- Përmirësim i sigurisë fizike dhe aspektit psikologjik përmes shërbimeve të specializuara (strehim, mbështetje psikosociale, juridike).
- Rritje e besimit tek institucionet për shkak të detyrimeve më të forta ligjore ndaj tyre.

Sasiore/Financiare

- Ulje e kostove të trajtimeve afatgjata të traumës nëse dhuna parandalohet më herët.
- Rritje e numrit të rasteve të raportuara (të matshme në vitin e parë 10–20%).
- Propabilitet më i lartë i punësimit ose socializimit të viktimave falë masave mbështetëse (trajnim, arsimi).

Ndikime jo të drejtpërdrejta

Cilësore

- Përmirësim i statusit socio-ekonomik të grave në afatgjatë përmes reduktimit të dhunës dhe diskriminimit.
- Ndryshim i normave shoqërore, fuqizim i rolit të grave në familje, komunitet dhe vendimarrje.

Sasiore

- Rritje e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës.
- Rritje e mundshme e kërkesës për shërbime psikosociale dhe programe rehabilitimi (kosto administrative).

b) Fëmijët

- Për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, kur është e nevojshme garantohen masa të përshtatshme dhe të posaçme mbrojtjeje, duke marrë parasysh interesin më të mirë të fëmijës;
- Nëse viktimë është fëmijë, shërbimet ofrohen në mënyrë të përshtatshme dhe në interesin më të lartë të fëmijës në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e viktimës.
- Në rastet kur dhuna ushtrohet ndaj ose në prani të fëmijëve, Policia e Shtetit merr menjëherë në mbrojtje fëmijën dhe njëkohësisht referon rastin pranë Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës.

Fëmijët (viktimë dhe dëshmitarë)

Ndikime të drejtpërdrejta

Cilësore

- Rritje e mbrojtjes së menjëhershme nga policia dhe shërbimet sociale.
- Procedura miqësore për fëmijët në raportim dhe dëshmi, duke reduktuar viktimizimin dytësor.
- Shërbime të dedikuara psikosociale dhe mbështetëse.

Sasiore

- Ulje e rrezikut të abuzimit të përsëritur (matet përmes reduktimit të rasteve të raportuara nga të njëjtat familje).
- Kursime afatgjata në sistemin shëndetësor dhe atë social, pasi trajtimi i hershëm parandalon humbje të mëvonshme ekonomike.

Ndikime jo të drejtpërdrejta

Cilësore

- Përmirësim i mirëqenies emocionale dhe performancës shkollore.
- Ndikim pozitiv në zhvillimin afatgjatë psikosocial.

Sasiore

- Reduktim i gjasave për përfshirje në sjellje të dhunshme në moshë madhore (efekt i matshëm në literaturë: reduktim 30–40%).

c) Burrat dhe djemtë

- angazhimin e tyre si aleatë dhe agjentë ndryshimi në parandalimin, çrrënjësien e paragjykimëve, zakoneve, traditave dhe të gjitha praktikave të tjera diskriminuese ndaj grave ose në rolet e stereotipizuara për burrat dhe gratë duke promovuar modele pozitive.

ç) Punëdhënësit dhe punëmarrësit (sektori publik dhe privat)

- Ligji u kërkon marrjen e masave kundër dhunës, ngacmimit dhe ngacmimit seksual në punë.
- Ligji parashikon masat administrative që merr punëdhënësi si dhe rolin në zbatim të vendimeve gjyqësore

- Ligji parashikon fushata ndërgjegjësimi për punëdhënësit, punëmarrësit dhe personat me funksione mbikëqyrëse në sektorin publik dhe privat, për parandalimin dhe trajtimin e ngacmimit seksual në vendin e punës;

Burrat dhe djemtë

Ndikime të drejtpërdrejta

Cilësore

- Përfitim nga programe edukimi mbi rolet gjinore dhe sjelljet jo të dhunshme.
- Ulje e konflikteve në familje përmes ndërgjegjësimit për barazinë gjinore.
- Ndryshim i normave të sjelljes, promovim i modeleve pozitive.

Sasiore

- Rritje e kërkesës për programe edukimi dhe ndërhyrje psikosociale për burrat dhunues (kosto shtesë për institucionet lokale).

Ndikime jo të drejtpërdrejta

Cilësore

- Përmirësim i marrëdhënieve familjare dhe komunitare.
- Reduktim i normave stereotipike që shtojnë presionin shoqëror ndaj burrave.

Sasiore

- Ulje e shpenzimeve publike për konfliktet familjare (për shembull, procese gjyqësore, ndërhyrje policore).

d) Autoritetet

• këtu përfshihen ministria përgjegjëse për çështje sociale dhe ato të dhunës në familje si autoriteti kryesor përgjegjës; Autoritetet përgjegjëse të linjës në nivel qendror ku bëjnë pjesë të gjitha ministratë dhe institucionet e tjera të administratës publike në nivel qendror sipas kompetencave dhe fushës së përgjegjësisë dhe institucionet e tyre të varësisë; Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe strukturat e tjera të përfshira në MKR.

- autoritetet kanë përgjegjësi/detyra të përgjithshme që garantojnë zbatimin në tërësi të ligjit dhe përgjegjësi/detyra që lidhen ngushtësisht me fushën e veprimtarisë të tyre.
- Autoritetet përgjegjëse përdorin mjetet e arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar vazhdimin e dhunës pavarësisht nëse viktimat tërhiqet nga procesi dhe pa cenuar sigurimin e shërbimeve.

Autoritetet publike (qendrore dhe vendore)

Ndikime të drejtpërdrejta

Cilësore

- Detyrim për të riorganizuar mekanizmat e koordinimit dhe referimit.
- Rritje e transparencës, llogaridhënies dhe monitorimit të politikave.
- Angazhim më i lartë në fushatat e parandalimit.

Sasiore/Financiare

- Rritje e kostove administrative për zbatimin e ligjit (trajnime, personel, IT).
- Shpenzime të parashikueshme për shërbimet e specializuara (strehim, shërbime psiko-sociale).
- Potencial për financim nga donatorët dhe fondet IPA për masat e koordinimit dhe IT.

Ndikime jo të drejtpërdrejta

Cilësore

- Përmirësim i efektivitetit të politikave sociale dhe gjinore.
- Rritje e besimit të publikut në institucionet shtetërore.

Sasiore

- Kursime afatgjata në kostot e drejtësisë, shëndetësisë dhe shërbimeve sociale, si rezultat i parandalimit.

e) Punëdhënësit dhe punëmarrësit (sektor publik dhe privat)

Ndikime të drejtpërdrejta

Cilësore

- Rritje e përgjegjësisë së punëdhënësit për të parandaluar dhe adresuar ngacmimin seksual/psikologjik në punë.
- Rregulla më të qarta për trajtimin formal dhe joformal të ankesave.
- Përmirësim i kulturës së punës dhe sigurisë në vendin e punës.

Sasiore/Financiare

- Kosto administrative fillestare për ngritjen e strukturave të brendshme të raportimit.
- Kursime afatgjata nga reduktimi i turn-over-it, mungesave në punë, konflikteve të brendshme.
- Ulje e rrezikut financiar nga paditë për ngacmim/dhunë në punë.

Ndikime jo të drejtpërdrejta

Cilësore

- Rritje e produktivitetit dhe performancës së punonjësve.
- Përmirësim i reputacionit institucional dhe të besimit të publikut.

Sasiore

- Rritje e korrektësisë organizative dhe ulje e kostove të menaxhimit të krizave.
- Kanë rol në ofrimin e shërbimeve civile shëndetësore dhe psikologjike, si dhe mbikqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të ligjit.

Organizatave të shoqërisë civile

Ndikime të drejtpërdrejta

Cilësore

- Zgjerim i rolit në ofrimin e shërbimeve për viktimat (qendra emergjence, këshillim, monitorim).
- Rritje e bashkëpunimit me institucionet publike.
- Përforsim i mekanizmave të advokimit.

Sasiore

- Mundësi rritjeje të financimeve publike dhe ndërkombëtare.
- Rritje e kapaciteteve për ofrimin e shërbimeve.

Ndikime jo të drejtpërdrejta

Cilësore

- Përmirësim i standardeve kombëtare për monitorimin e dhunës.

Sasiore

- Kontribut në reduktimin e rasteve të dhunës (indikatore të matshëm: raste të referuara, raste të menaxhuara, efikasiteti i shërbimeve).

Identifikimi i llojeve të ndikimeve të përgjithshme për të gjitha kategoritë (Drejtpërdrejta dhe Jo të Drejtpërdrejta)

- Ndikimet e drejtpërdrejta

Këto ndikime janë ato që do të ndihen menjëherë pas miratimit të opsionit të preferuar

- a) Për gratë dhe vajzat:

- Përmirësimi i rolit të grave dhe vajzave në familje, i qasjes jodiskriminuese dhe jo ngacmuese në marrëdhëniet e punës.

- Mbrojtje nga diskriminimi dhe dhuna, përmes forcimit të mekanizmave ligjorë dhe masave kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

- b) Për burrat dhe djemtë:

- Ndryshime në ndërgjegjësimin për ndarjen e roleve tradicionale në familje duke synuar respektin ndaj grave dhe vajzave, duke u dhënë më shumë mundësi për të ndarë e për të marrë përsipë përgjegjësitë familjare.

- Përmirësim i kushteve të punës, larg dhunës, diskriminimit dhe ngacmimit në ambjentin e punës.

- c) Për punëdhënësit:

- Nevoja për përshtatje me standardet e parandalimit dhe mbrojtjes nga dhuna, diskriminimi dhe ngacmimi në vendet e punës si në institucionet publike ashtu edhe në operatë të punëdhënës privatë.

- Ngritja e strukturave që mundësojnë analizën e rasteve të dhunës në punë dhe mekanizmin e referimit me qëllim trajtimin joformal dhe trajtimin përmes procedurave formale të situatave të dhunës ndaj grave dhe vajzave.

d) Për institucionet publike:

- Detyrimi për të integruar buxhetimin gjinor, që kërkon planifikim të kujdesshëm të burimeve financiare.
- Nevoja për krijimin e mekanizmave të monitorimit, për të siguruar që parimet e mbrojtjes së grave nga diskriminimi, dhuna dhe ngacmimi të zbatohen në mënyrë efektive.

- Ndikimet jo të drejtpërdrejta

a) Për shoqërinë në përgjithësi:

- Ndryshim i mentalitetit dhe kulturës shoqërore, me një promovim të madh të mbrojtjes së grave nga diskriminimi, dhuna dhe ngacmimi si vlerë shoqërore.

- Përmirësim i cilësisë së jetës dhe i veprimtarisë profesionale të grave, duke reduktuar trajtimin e diferencuar dhe dhunën e të gjitha llojeve.

Analiza e ndikimeve të drejtpërdrejta

Ligji për mbrojtjen e grave nga dhuna, diskriminimi dhe ngacmimi synon të ndikojë në mënyrë të thellë në të gjitha aspektet e jetës shoqërore dhe ekonomike, duke krijuar një kuadër të qartë për eliminimin e të gjitha formave të dhunës, fizike, psikologjike, digjitale, etj. Ai vendos standarde të reja për sektorët kyç të shoqërisë, duke integruar parimet e mbrojtjes së grave nga dhuna në familje, nga diskriminimi dhe ngacmimi.

Në terma sasiore zbatimi i projektligjit mund të sjellë disa ndikime:

- Parandalimin dhe reduktimin e rasteve të dhunës në familje, punë dhe shoqëri, së grave nga diskriminimi, dhuna dhe ngacmimi si dhe ndërgjegjësimin e grave dhe vajzave për të gjetur mënyrën e referimit të rastit dhe të gjetjes së rrugëzgjdhjeve për eliminimin e pasojave.

- Mbrojtjen, e viktimave nga skenarë të dhunës në familje, punë dhe shoqëri, së grave nga diskriminimi, dhuna dhe ngacmimi, duke përfshirë edhe mbrojtjen e fëmijëve, pavarësisht nëse janë viktimë apo dëshmitarë të dhunës në familje.

- Marrjen e masave për punësimin dhe arsimimin e viktimave të dhunës si dhe sigurimin e masave me karakter shëndetësor, social dhe psikologjik në drejtim të kapërcimit të traumave të krijuara nga dhuna dhe ngacmimi.

- **Kufizimet e Analizës**

- **Supozimet dhe Risqet**

Për të siguruar që ligji për mbrojtjen e grave nga dhuna në familje dhe diskriminimi të ketë ndikimin e synuar, supozohet se institucionet publike dhe private do të zbatojnë dispozitat e tij në mënyrë efektive dhe të qëndrueshme. Kjo përfshin angazhimin e administratës publike, bizneseve, organizatave të shoqërisë civile dhe komunitetit të gjerë për të integruar parimet e mosdiskriminimit në politikat dhe praktikën e tyre të përditshme.

Megjithatë, një nga rreziqet kryesore që mund të sfidojë zbatimin e ligjit është **rezistenca kulturore**. Në disa segmente të shoqërisë, normat dhe traditat patriarkale mund të vështirësojnë pranimin e ndryshimeve të propozuara nga ligji. Për shembull, në disa komunitete ndarja e përgjegjësisë familjare në mënyrë të barabartë mund të hasë kundërshtime nga individë ose grupe me bindje tradicionale të rrënjësura.

Një tjetër rrezik i rëndësishëm është **mungesa e burimeve të mjaftueshme** për zbatimin e plotë të masave dhe procedurave për mbrojtjen nga dhuna dhe diskriminimi në marrëdhëniet familjare dhe më gjerë. Implementimi efektiv i ligjit kërkon fonde për ngritjen e mekanizmave të monitorimit, trajnimin e administratës publike dhe sektorit privat mbi standardet e reja, si dhe për mbështetjen e programeve që synojnë mbrojtjen e grave nga dhuna dhe

diskriminimi. Nëse burimet financiare dhe njerëzore nuk janë të mjaftueshme, ekziston rreziku që ligji të mbetet një kuadër teorik pa ndikim real në shoqëri.

Për më tepër, suksesi i ligjit varet nga një **angazhim i vazhdueshëm politik**, si në nivel qendror, ashtu edhe në atë vendor. Nëse institucionet nuk e prioritojnë zbatimin e tij ose nëse ndryshimet e udhëheqjes sjellin zhvendosje të fokusit politik, ligji mund të mos zbatohet në mënyrë të plotë ose mund të përballlet me vonesa dhe sfida burokratike.

Faktorët që mund të pengojnë përfitimet

Megjithëse ligji për mbrojtjen nga dhuna ndaj grave në familje dhe diskriminimi ka potencialin për të sjellë ndryshime të mëdha pozitive, disa faktorë mund të pengojnë arritjen e përfitimeve të tij të plota.

Një nga sfidat kryesore është mungesa e fondeve të dedikuara për zbatimin e ligjit. Për të pasur sukses, kërkohen burime të mjaftueshme financiare për të mbështetur mekanizmat e monitorimit dhe mbikëqyrjes, për të ofruar trajnime dhe për të krijuar programe specifike që promovojnë mbrojtjen e grave nga dhuna në familje dhe diskriminimi. Në mungesë të financimeve të mjaftueshme, shumë nga dispozitat e ligjit mund të mbeten të pazbatuara, duke kufizuar efektivitetin e tij në praktikë.

Një tjetër faktor që mund të ndikojë në suksesin e ligjit është paqëndrueshmëria politike. Prioritetet qeveritare mund të ndryshojnë me ndërrimin e qeverive, dhe nëse politika për mbrojtjen e grave nga dhuna në familje dhe diskriminimi nuk shihet si një çështje prioritare nga udhëheqësit politikë të ardhshëm, mund të ketë vonesa në zbatimin e politikave ose ulje të financimeve për programet mbështetëse. Kjo do të kufizonte ndikimin e ligjit dhe mund të pengonte arritjen e objektivave të tij afatgjata.

Gjithashtu, mungesa e koordinimit mes institucioneve përgjegjëse mund të krijojë pengesa në zbatimin efektiv të ligjit. Nëse nuk ka një mekanizëm të qartë për ndarjen e përgjegjësisë dhe raportimin mbi progresin, mund të krijohen boshllëqe në monitorim dhe vlerësim, duke vështirësuar identifikimin dhe adresimin e sfidave në kohë.

Në fund, për të siguruar që ligji të arrijë efektet e dëshiruara, është thelbësore të forcohet ndërgjegjësimi dhe mbështetja e publikut. Nëse qytetarët, bizneset dhe administrata publike nuk janë të informuar mbi përfitimet e këtij ligji dhe mbi detyrimet që ai përcakton, zbatimi mund të mbetet sipërfaqësor ose selektiv. Fushatat e edukimit dhe informimit luajnë një rol kyç në adresimin e kësaj sfide, duke siguruar që shoqëria të jetë e angazhuar në promovimin dhe respektimin e parimeve dhe rregullave për mbrojtjen e grave nga dhuna në familje dhe diskriminimi e ngacmimi..

Në përmbledhje, edhe pse ky ligj ka potencial për të transformuar qasjen ndaj mbrojtjes së grave nga dhuna në familje dhe diskriminimi në Shqipëri, suksesin e tij do ta përcaktojë angazhimi i institucioneve për zbatimin efektiv, sigurimi i burimeve të nevojshme dhe kapërcimi i pengesave kulturore dhe politike që mund të lindin gjatë rrugës.

Si më poshtë paraqitet tabela për analizën e ndikimeve për secilin prej opsioneve:

Opsioni	Efektet	Kostoja	Zbatueshmëria
Opsioni 1 Ruajtja e status quo-së	Nuk ka ndikim të rëndësishëm në masat e mbrojtjes së grave nga dhuna në familje dhe diskriminimi	Nuk kërkon fonde shtesë	E lehtë për t'u zbatuar, por jo efektive
Opsioni 2 (Rregullator): Ndërhyrje të targetuara në aktet ligjore sektoriale	Ndikim i kufizuar dhe jo gjithëpërfshirës	Kosto më e ulët për ndryshime të kufizuara	E mundshme për t'u zbatuar në sektorë specifikë

Opsioni 3 (Rregullator): Bërja e ndryshimeve në ligjin Nr. 9669/2018 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”	Ndikim më i madh, por varet nga harmonizimi me aktet ekzistuese	Kostoja do të varet nga masa e ndryshimeve që mund të bëheshin në ligjin ekzistues	Mund të kërkojë harmonizim të mëtejshëm ligjor
Opsioni 4 (I rregullator): Hartimi i një ligji të ri për mbrojtjen e grave nga dhuna në familje dhe diskriminimi	Ndikimi më i madh dhe i strukturuar mbi mbrojtjen e grave nga dhuna	Kosto e lartë për hartimin dhe zbatimin e ligjit të ri	Vështirësi fillestare, por zbatimi i qëndrueshëm

Ndikimi në Buxhetin e Shtetit

Llogaritja e efektit financiar bazohet në analizën e bërë për kostimin e ligjit “Për Parandalimin dhe Mbrojtjen ndaj Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje”⁸. Shpenzimet për zbatimin e këtij projektligji alokohen dhe përballohen nga disa institucione dhe programet buxhetore respektive të tyre. Në këtë analizë u vlerësuan shpenzimet vjetore për periudhën 10 vjeçare 2026-2035, në një format që mbështet dhe/ose orienton autoritetet përgjegjëse në planifikimin e buxhetit.

Efekti i përgjithshëm financiar është vlerësuar **2 014.1 milion lekë** i shpërndarë në dhjetë vite ose sa 7.3% e PBB së parashikuar për vitin 2026. Shumat sipas viteve në milionë lekë janë: (2026 -148.7 milionë; 2027- 222.7 milionë; 2028 - 322.7 milionë, 2029- 160 milionë, 2030 - 260 milionë, 2031 - 160 milionë, 2032 - 160 milionë, 2033 – 160 milionë, 2034 - 160 milionë dhe 2035 - 260 milionë). Pjesa tjetër e shpenzimeve mbulohet nga tavanet buxhetore të miratuara të autoriteteve përgjegjëse. Aneksi mbi efektet financiare paraqet koston për çdo vit të periudhës 2026 - 2035, burimin e financimit dhe institucionin përgjegjës. Gjithashtu, në aneks jepet dhe kodi i programit buxhetor.

Më poshtë janë paraqitur shpenzimet vetëm për ato nene zbatimi i të cilave është vlerësuar që sjell efekte shtesë në buxhetin e autoriteteve përgjegjëse përtej tavanëve buxhetore.

1. Fonde për miratimin e akteve nënligjore. Në disa nene të ligjit si (13, 15, 16, 17, 20, 21, 34, 50, dhe 52) parashikohet hartimi i procedurave, udhëzimeve, rregullore dhe VKM, të cilat duhet të miratohen 6 muaj pasi të jetë miratuar ligji. Shpenzimet të përlllogaritura për të gjitha nenet e cituara janë rreth 126 milionë lekë dhe janë kosto për buxhetin vetëm një herë. Shpenzimet për këto nene janë për vitin 2026 dhe vlerësohen të mbuluara nga tavanet e miratuara të shpenzimeve buxhetore afatmesme për të gjitha autoritetet përgjegjëse. 19, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 53, 54 dhe 55

2. Kostot financiare për aktivitetet që rrjedhin nga zbatimi i disa neneve të tjera të këtij projektligji si nenet (19, 34, 35, 36, 37, 38, 39, 40, 41, 42, 43, 46, 47, 48, 49, 53, 54 dhe 55) mbulohen nga tavanet e miratuara të shpenzimeve buxhetore afatmesme të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e projekt ligjit dhe nuk krijojnë efekte buxhetore shtesë.

3. Ndërgjegjësimi dhe edukimi publik Neni 44 i ligjit parashikon realizimin mbi baza vjetore të fushatave ose programe të rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut. Zbatimi i këtij neni kërkon alokimin e fondeve të dedikuara për Autoritetin kryesor përgjegjës. Shuma e llogaritur është 20 milionë për çdo vit për periudhën 2026 -

⁸ Analiza është bërë me mbështetjen ekspertëve të UN ëomen në tetor 2025

2035 ose 200 milionë në total. Autoritetin kryesor përgjegjës do të planifikoj për çdo vit buxhetor natyrën e aktiviteteve që do të realizojë dhe shpenzimet e detajuara.

4. Trajnimi i profesionistëve - Viktimat e dhunës sipas këtij ligji trajtohen vetëm nga profesionistë të trajnuar dhe specializuar në këtë fushë. Ekspertiza, kualifikimi dhe format e trajnimit janë parashikuar në nenin 45 . Miratimi i ligjit kërkon ofrimin e trajnimeve për të gjitha kategoritë e profesionistëve. Shpenzimet për trajnime janë vlerësuar vetëm për periudhën 2026-2028 dhe më pas Autoriteti kryesor përgjegjës dhe autoritetet e tjera duhet të mbështeten në vlerësimin e nevojave për të parashikuar trajnimet.

Në total është parashikuar si shpenzim i ri shuma prej 8.1 milionë lekë ku përfshihet trajnimi i 300 profesionistëve çdo vit për periudhën 2026-2028 për zbatimin e këtij ligji. Trajnimet do të jenë 2 ditore dhe kosto për person të trajnuar 9000 lekë. Në këtë shumë nuk janë përfshirë shpenzimet e planifikuara për trajnime mbi dhunën me bazë gjinore dhe dhunën në familje para hyrjes në fuqi të ligjit nga autoritete publike dhe private për periudhën 2026-2028.⁹ Autoriteti kryesor përgjegjës dhe institucionet me detyra trajnuese do të planifikojnë numrin dhe tematikën e trajnimeve mbështetur në nevojat e identifikuara.

5. Regjistri Kombëtar i Dhunës Digjitale

Neni 23 parashikon krijimin e Regjistrimit Kombëtar të Dhunës Digjitale. Efekti total për këtë projekt bazuar në projekte të ngjashme vlerësohet 120 milionë për periudhën 2027-2028. Kostot e mirëmbajtjes duhet të vlerësohen përpara futjes në përdorim nga autoriteti përgjegjës.

Efektet e ligjit për NJVV

Disa nene përcaktojnë detyra për NJVV. Shpenzimet janë vlerësuar të mbuluara nga buxheti i NJVV (granti i pakushtëzuar dhe të ardhurat e veta) sipas legjislacionit në fuqi. Miratimi i këtij ligji krijon efekte financiare shtesë për ato njësi që nuk ofrojnë në territorin e tyre shërbimeve mbështetëse të përgjithshme dhe të specializuara. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të parashikojnë fonde të nevojshme, në Fondin Social Lokal për ofrimin e këtyre shpenzimeve dhe sipas rastit mund dhe t'i bashkëfinancojnë këto shërbimeve. Shpenzimet për shërbime të reja (për të gjitha bashkitë nga të ardhurat e tyre) janë vlerësuar 40 milionë lekë në vit për periudhën 2027-2035 ose 360 milionë në total.

Bashkëfinancimi nga Autoriteti kryesor përgjegjës për projektet e NJVV është vlerësuar 100 milionë çdo vit, për të gjithë periudhën 2026-2035. Autoriteti kryesor përgjegjës ka një product në PBA për Shërbime të reja sociale për grupet në nevojë të ofruara nëpërmjet njësive vendore nga financimi i fondit social (91307AH). Njësitë e vetëqeverisjes vendore konkurojnë me projekte për financimin e shërbimeve të reja sociale, të cilat janë projekte 3 vjeçare. Numri i NJQV që kanë përfituar nga programi në vitin 2025 ka qënë 43 dhe ky numër është parashikuar në rritje deri në vitin 2028 (PBA 2026-2028). Buxheti vjetor i planifikuar është mbi 400 million për periudhën 2026-2028 dhe është parashikuar që rreth 25% të përdoret për mbështetjen e shërbimeve mbështetëse të përgjithshme dhe të specializuara për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

7. Neni 57 ka parashikuar realizimin e **dy studimeve kombëtare** mbi prevalencën e të gjitha formave të dhunës. Studimet duhet të realizohen në çdo 5 vjet. Kostoja e studimit që duhet të realizohet nga INSTAT është vlerësuar 100 milionë për secilin studim, mbështetur në kostot e studimeve të ngjashme. Studimi i parë duhet të realizohet në vitin 2030.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

7. *Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.*

8. *Shpjegoni arsyetimin tuaj.*

⁹ Aktualisht ka trajnime për dhunën për të dy nivelet e qeverisjes. Duhet të përfshihen trajnime shtesë në kalendarin e trajnimeve për çdo vit financiar mbi bazën e tematikave të dakortësuara.

Objektivat e politikës në kuadër të të cilës u përgatit ky projektligj “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, që propozohet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), kanë si qëllimi kryesor mbrojtjen e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje përmes masave të përshtatshme ligjore, masave të tjera të nevojshme dhe politikave të integruara dhe gjithëpërfshirëse.

Shqyrtimi i konflikteve me shpejtësi dhe pa vonesë mbetet një nga objektivat kryesorë për t’iu përgjigjur dhunës nga grave dhe vajzave në familje, punë dhe shoqëri përmes mjeteve juridike civile dhe administrative. Kjo synon rivendosjen në vend të të gjitha të drjetave të cenuara në të gjitha rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, të cilat shkelin integritetin fizik, psikologjik, social, ekonomik, seksual, të viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Zbatimi i masave ligjore dhe administrative për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, parashikohet ndaj çdo personi, do të shtrihet për herë të parë në legjislacionin shqiptar si në subjektet publike, ashtu dhe në ato private.

Parandalimi i të gjitha formave të dhunës ndaj grave në gjithë sektorët e veprimtarisë dhe dhunës në familje, mbetet objektiv i rëndësishëm i politikës qeveritare dhe shtetërore,

Krijimi i një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave, parandalimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, si dhe lehtësimi i pasojave duke përcaktuar edhe funksionimin e strukturave të organeve përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor mbeten në qendër të vëmendjes institucionale dhe shtetërore bashkëpunimi efektiv ndër-institucional ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, synon një qasje të integruar për të parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Një tjetër objektiv i politikës është forcimi i sistemit gjyqësor, me qëllim marrjen e masave të menjëhershme të mbrojtjes ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje si dhe garantimin për viktimat e dhunës të aksesit të shpejtë, falas dhe të thjeshtuar pranë gjykatave ose organeve të tjera kompetente.

Projektligji hartohet në vazhdimësinë e politikave të ndërmarra nga shteti shqiptar për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, duke e zgjeruar fushën e zbatimit për të gjitha format e dhunës ndaj grave (jo vetëm dhunën në marrëdhënie familjare), pa përjashtim të mjedisit ku kryhen apo mjetit përmes të cilit realizohen, duke siguruar mbrojtjen nga dhuna ndaj grave në sferën publike dhe private, përfshirë kontekstet e familjes, të komunitetit, në hapësirat publike, në vendin e punës dhe praktikave profesionale, gjatë kohës së lirë, në politikë, në veprimtaritë sportive, shërbimeve shëndetësore, mjedisve arsimore dhe argëtuese, përfshirë mjediset e ndërmjetësuar nga teknologjia, siç janë dhuna e lehtësuar nga teknologjia dhe në mjedise të tjera digjitale, duke përfshirë edhe viktimat e veprave penale të parashikuara në Kodin Penal; viktimat në kohë paqeje, në situata konflikti të armatosur dhe në situata emergjente.

Projektligji i propozuar “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, do të kontribuojë për realizimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 dhe planit të saj të veprimit (VKM nr. 400, datë 30.06.2021), Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritet 2022–2030 (VKM Nr. 88, datë 22.2.2023), si dhe lidhet me strategji të tjera ndërsektoriale dhe plane veprimi, si: Strategjia Kombëtare e Sigurisë Kibernetike 2020-2025 (VKM nr. 1084/2020), Axxhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, si dhe aktet e hartuara politike për përparimin e procesit të integritetit evropian të vendit.

Opsioni i preferuar është përzgjedhur opsioni 3: Hartimi i Ligjit të Ri **“Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”**

Zgjedhja e Opsionit të Preferuar vjen si nevojë për një kuadër rregullator të përmirësuar dhe të harmonizuar me standardet ndërkombëtare.

Pas një analize të thelluar mbi opsionet e mundshme për adresimin e çështjeve të parandalimit dhe mbrojtjes ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, opsioni më i përshtatshëm dhe i preferuar është hartimi i një ligji të ri. Ky opsion është zgjedhur sepse adreson në mënyrë gjithëpërfshirëse sfidat ekzistuese dhe siguron një kuadër të përditësuar, të qartë dhe të detyrueshëm për të gjitha aktorët e përfshirë në parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje duke synuar mbrojtjen efektive nga të gjitha format e dhunës pavarësisht nëse kjo ndodh në familje

e mes pjesëtarëve të familjes apo efektin gratë në sektorë të ndryshëm të jetës publike dhe në sektorët e veprimtarisë private.

Ligji aktual “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (9669/2006 ndryshuar) ka disa mungesa të cilat nevojitet të përmirësohen. Ai nuk është plotësisht i harmonizuar me legjislacionin e Bashkimit Evropian si Direktivën e (BE-së) nr.1385/2024, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 14 maj 2024, “Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, Konventën e Këshillit të Evropës, “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, Konventën nr. 190 “Mbi dhunën dhe ngacmimin në botën e punës” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, raportet e GREVIO-s dhe rekomandimet e Komisionit Evropian për Shqipërinë.

Për më tepër, ai nuk reflekton nevojën për mbrojtje ndaj dhunës jashtë sferës së marrëdhënieve familjare, duke krijuar një boshllëk në zbatimin efektiv të masave kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Prandaj, hartimi i një ligji të ri “**Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje**” do të krijojë një kuadër ligjor të përmirësuar, më të fortë dhe më gjithëpërfshirës, duke siguruar që Shqipëria jo vetëm të përmbushë detyrimet e saj ndërkombëtare, por edhe të krijojë një sistem të qëndrueshëm për eliminimin e **dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje** dhe mbrojtjen e viktimave të cfarëdo forme të dhunës.

Drejtimet kryesore të përmirësimeve të ofruara nga ligji i ri:

1. Mbrojtje gjithëpërfshirëse e pjesëtarëve të familjes dhe mbrojtja e grave nga të gjitha format e dhunës

Një nga sfidat kryesore të ligjit aktual është që ai siguron mbrojtje vetëm për pjesëtarët e familjes duke u fokusuar vetëm në marrëdhëniet familjare dhe lënë jashtë gratë e dhunuara jashtë jetës dhe marrëdhënieve familjare. Kështu që ligji i ri mban në konsideratë parandalimin, reduktimin dhe mbrojtjen nga të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje në veprimtarinë publike, private, përfshirë dhunën në mjedisin digjital.

2. Përputhje me Standardet Evropiane dhe Ndërkombëtare

Opsioni i preferuar synon harmonizimin e kuadrit ligjor kombëtar me direktivat e BE-së dhe konventat ndërkombëtare. Kjo përputhje është thelbësor për procesin e integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Shqipëria ka detyrime për të përmirësuar **parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje** si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE dhe për të përmbushur standarde të larta ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut në situata të dhunës kudoqoftë kjo pavarësisht mjedisit. Në këtë aspekt, projektligji i propozuar do të përfshijë rregulla të qarta për zbatimin e masave mbrojtëse nga çdo formë e dhunës kundër grave.

3. Forcimi i Institucioneve Përgjegjëse për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Projektligji synon krijimin e një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor duke nënvizuar edhe rolin e organizatave të shoqërisë civile, medias dhe sektorit privat, me qasje të integruar duke patur në qendër viktimën si dhe forcimin e sistemit gjyqësor për marrjen e masave të menjëhershme të mbrojtjes ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Gjithashtu për viktimat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje garantohej aksesin i shpejtë, falas dhe i thjeshtuar në mjetet juridike pranë gjykatave ose organeve të tjera përgjegjëse.

Projektligji synon fuqizimin e mekanizmit duke u ndalur në rolin e autoritetit kryesor përgjegjës (Ministria që mbulon çështjet e barazisë gjinore dhe çështjet sociale), autoritetet përgjegjëse të linjës ku përfshihen të gjitha ministritë dhe institucionet e tjera të administratës publike në nivel qendror dhe institucionet e tyre të varësisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe strukturat e tjera të përfshira në MKR. Subjekte me rëndësi në zbatimin e këtij ligji janë: organizatat jofitimprurëse të cilat ushtrojnë veprimtari në fushën e luftës ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje; profesionet e lira dhe urdhrat e psikologut dhe të punojësit social, media dhe subjektet private sipas detyrave të përcaktuara për zbatimin e këtij ligji. Ligji ka një paketë të detajuar me përgjegjësi/detyra të përgjithshme që garantojnë zbatimin në tërësi të ligjit dhe si të tilla i përkasin çdo autoriteti sikurse ka dhe përgjegjësi/detyra që lidhen ngushtësisht me fushën e veprimtarisë së tyre specifike.

4. Mbledhja dhe Analiza e të Dhënave

Ligji i ri do të garantojë që të dhënat të mbledhen dhe analizohen në mënyrë të rregullt, duke mundësuar matjen e progresit të parandalimit dhe mbrojtjes dhe identifikimin e fushave ku ka nevojë për ndërhyrje shtesë. Kjo do të ndihmojë në krijimin e politikave më të sakta dhe të bazuara në fakte për aspekte të lidhura me dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Autoriteti kryesor përgjegjës bashkërendon punën për mbledhjen dhe mbajtjen e të dhënave statistikore nga autoritetet përgjegjëse dhe subjektet publike e private dhe paraqet raportin vjetor pranë komisionit përgjegjës parlamentar/nënkomisionin për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës ndaj grave.

5. Integrimi i Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor

Një nga elementët më të rëndësishëm të ligjit të ri është integrimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të gjitha politikat publike. Kjo do të sigurojë ndarje efektive të burimeve financiare për politika dhe programe që promovojnë barazinë gjinore, duke e bërë këtë një prioritet të qartë në planifikimin ekonomik të vendit.

6. Përfshirja e Sektorëve

Ligji i ri do të adresojë detyra konkrete në sektorë kyç, si rendit dhe sigurisë publike; shëndetësisë; drejtësisë; arsimit, punësimit, *informimit publik dhe medias* dhe institucionet e varësisë; Mekanizmi i Koordinuar i Referimit dhe NJQV, etj. Ligji synon forcimin e sistemit gjyqësor për marrjen e masave të menjëhershme të mbrojtjes ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;

Përmes mekanizmave specifikë, do të krijohen politika për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave.

7. Përmbushja e Detyrimeve Ndërkombëtare

Shqipëria ka detyrime për të zbatuar standardet ndërkombëtare për mbrojtjen dhe parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Ligji i ri do të ndihmojë vendin të përmirësojë raportet e saj me organizatat ndërkombëtare, duke treguar një angazhim serioz për reduktimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Kjo do të ndikojë pozitivisht në procesin e integrimit evropian dhe në tërheqjen e fondeve dhe investimeve për programe të lidhur me çështjet e fuqizimit të grave, eliminimit të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

Sa më sipër, hartimi i një ligji të ri është zgjidhja më e mirë, sepse ai garanton një qasje të fortë, të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse ndaj kësaj çështjeje thelbësore. Ai siguron mekanizma të qartë zbatimi, struktura profesionale dhe me profil të qëndrueshëm dhe një përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare, duke e bërë parandalimin e dhunës një realitet të prekshëm.

Për të bërë të mundur një vlerësim objektiv të opsioneve është kryer analiza me shumë kriteret.

Fillimisht, janë përcaktuar kriteret që tregojnë arritjen e objektivave:

- Harmonizimi i legjislacionit me Acquis-in e BE-së dhe me standardet ndërkombëtare dhe të BE;
- Efektiviteti në parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave;
- Forcimi i rolit dhe përgjegjësi të institucioneve për zbatimin e ligjit;
- Efektiviteti në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave;
- Qartësia dhe kuptueshmëria juridike;
- Kosto-efektiviteti.

Në vijim, përcaktohet pesha për secilin prej këtyre kriterëve sipas rëndësisë relative nga 1 deri në 5:

- Harmonizimi i legjislacionit me Acquis-in e BE-së dhe me standardet ndërkombëtare dhe BE;-4
- Efektiviteti në parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave;-5
- Forcimi i rolit dhe përgjegjësi të institucioneve për zbatimin e ligjit;-4
- Efektiviteti në mbledhjen dhe analizën e të dhënave;- 3
- Qartësia dhe kuptueshmëria juridike- 4
- Kosto-efektiviteti- 5

Kriteret	Pesha	Opsioni 1	Opsioni 2	Opsioni 3	Opsioni 4	Opsioni 5
Harmonizimi i legjislacionit me Acquis-in e BE-së dhe me standardet ndërkombëtare dhe të BE	4	0 (0)	2 (8)	3 (12)	4 (16)	0(0)
Efektiviteti në parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave	5	1 (5)	2 (10)	5 (25)	5 (25)	2(10)
Forcimi i rolit dhe përgjegjësi të institucioneve për zbatimin e ligjit	3	1 (3)	2(6)	3 (9)	3(9)	2(6)
Efektiviteti në mbledhjen dhe analizën e të dhënave	3	1 (3)	3 (9)	3 (9)	3 (9)	2(6)
Qartësia dhe kuptueshmëria juridike	4	2 (8)	3 (12)	2 (8)	4 (16)	1(4)
Kosto-efektiviteti	5	2 (8)	3 (12)	(16)	5 (25)	3(12)
Pikët		27	57	79	100	38

Bazuar në analizën e mësipërme, vlerësohet se opsioni i preferuar është Opsioni 4 (Hartimi i ligjit të ri “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”).

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e ligjit.*

Struktura përgjegjëse është Ministria që mbulon çështjet e barazisë gjinore dhe çështjet sociale (aktualisht Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale). Gjithashtu grupi i punës për hartimin e këtij projektligji ka anëtarë nga institucione të tjera si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Ministria e Pushtetit Vendor, Perfaqësues nga DP e policisë së Shtetit. Pa u kufizuar, autoritetet e tjera përgjegjëse të linjës përfshijnë: gjithë ministrinë dhe institucionet e tjera të administratës publike në nivel qendror sipas kompetencave dhe fushës së përgjegjësisë dhe institucionet e tyre të varësisë; Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe strukturat e tjera të përfshira në MKR; organizatat jofitimprurëse të cilat ushtrojnë veprimtari në fushën e luftës ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje; profesionet e lira dhe urdhrat e psikologut dhe të punojësit social, media dhe subjektet private.

- Pengesat e Mundshme për Zbatimin e Opsionit të Zgjedhur

1. Mungesa e burimeve financiare dhe njerëzore

- Një nga sfidat kryesore do të jetë sigurimi i fondeve të nevojshme për zbatimin e ligjit për shkak të faktit se mekanizmi aktual është më shumë i orientuar nga dhuna në familje ndërkohë që ligji i ri adreson dhe përfshihen të gjitha format e dhunës ndaj grave pavarësisht mjedisit.
- Mungesa e burimeve njerëzore të specializuara mund të pengojë zbatimin efektiv të ligjit sidomos sa i përket MKR dhe strukturave në pushtetin vendor, por edhe në sektorët e punës qofshin këto publik ose privat.

- Sigurimi i strukturave adekuate që ofrojnë shërbime të rehabilitimit të viktimave dhe të dhunuesve, që, mbështesin me ndihmë psikosociale, shëndetësore e financiare personat e dhunuar në familje, si dhe të monitorojnë respektimin e urdhrave të mbrojtjes nga palët, duke paraqitur raportet përkatëse përpara koordinatorit vendor për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare me qëllim sigurimin urdhërimit e organeve përgjegjëse, shërbimeve sociale të njëjseve përkatëse të vetëqeverisjes vendore dhe/ose organizatave ;

2. Rezistenca kulturore dhe ndryshimi i mentalitetit

- Në disa komunitete dhe institucione mund të ketë rezistencë ndaj masave të reja dhe mbrojtjen të lidhura me dhunë ndaj grave, ndalimit të gjuhës seksiste, gjuhës së urrejtjes, eliminimin e stereotipeve gjinore, paragjytimeve, zakoneve ose modeleve të sjelljeve shoqërore diskriminuese; kuptimin dhunës në mjedisin digjital; dhuna dhe ngacmimi ndaj grave në politikë.

3. Koordinimi i pamjaftueshëm midis institucioneve

- Për një zbatim efektiv, nevojitet një bashkëpunim i ngushtë mes ministrive, institucioneve vendore dhe sektorit privat. Programet për viktimat zbatohen në koordinim me shërbimet mbështetëse dhe synojnë sigurinë dhe mirëqenien e viktimës. Qëllimi i ligjit është gjithashtu krijimi i një rrjeti të koordinuar institucionesh përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor si dhe organizatave të shoqërisë civile, me qasje të integruar duke patur në qendër viktimën. Mekanizmi i Koordinuar i Referimit të rasteve të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” (më poshtë MKR) është rrjeti i organizuar i institucioneve përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen me shërbime dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.

- Mungesa e përvojës në monitorim mund të krijojë boshllëqe në zbatim.

4. Ndryshimet e shpeshta në struktura

- këto mund të ndikojnë në prioritetet e ligjit, duke çuar në vonesa dhe cenimin e kujdesit të duhur.

Masat që do të ndërmerren për të Arritur Qëllimet e Ligjit “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” detajohen si më poshtë:

Për të siguruar një zbatim të suksesshëm dhe të qëndrueshëm të ligjit të ri “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”, është thelbësore që të ndërmerren masa konkrete dhe të mirëpërcaktuara. Këto masa do të ndihmojnë në krijimin e një mjedisi institucional dhe social ku parandalimi dhe mbrojtja ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje të mos mbetet vetëm në nivel deklarativ, por të zbatohet realisht. Në këtë kontekst, masat kryesore që do të ndërmerren për të arritur qëllimet e këtij ligji janë si më poshtë:

1. Edukimi dhe Ndërgjegjësimi Publik me qëllim parandalimin dhe mbrojtjen

Për të ndryshuar perceptimet dhe për të krijuar një kulturë parandaluese ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, është thelbësore që të zhvillohen fushata ndërgjegjësimi dhe programe edukative. Të tilla përfshijnë:

- aktivitetet me natyrë ndërgjegjëse mbi format, raportimin dhe pasojat e dhunës, identifikimin e hershëm dhe mekanizmat mbrojtës;
- angazhimi e burrave dhe djemve si aleatë dhe agjentë ndryshimi në parandalimin, çrrënjosjen e paragjytimeve, zakoneve, traditave dhe të gjitha praktikave të tjera diskriminuese ndaj grave ose në rolet e stereotipizuara për burrat dhe gratë duke promovuar modele pozitive.
- aktivitete edukative për fëmijët dhe të rinjtë përfshirë ato mbi rreziqet e dhunës online dhe cenimin e privatësisë nga përmbajtjet e dëmshme në platformat digjitale;
- publikime, broshura, video, për edukimin publik, në gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme si dhe në formate të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara;
- fushata ndërgjegjësimi për punëdhënësit, punëmarrësit dhe personat me funksione mbikëqyrëse në sektorin publik dhe privat, për parandalimin dhe trajtimin e ngacmimit seksual në vendin e punës;
- përgatitjen e emisione televizive.
- Integrimi në arsimin parauniversitar, universitar module për parandalimin dhe mbrojtjen e të gjitha formave të dhunës.

- Do të forcohen kapacitetet e medias për raportim të ndjeshëm ndaj të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje duke parandaluar përhapjen e stereotipeve.

2. Sigurimi i Burimeve Financiare dhe Ngritja e Kapaciteteve Institucionale

Një nga shtyllat kryesore për suksesin e ligjit të ri “Për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje” është sigurimi i burimeve të nevojshme financiare dhe forcimi i institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tij. Për këtë qëllim:

- Do të përcaktohet një buxhet i dedikuar për barazinë gjinore në buxhetin e shtetit ku dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje do të përfshihet në të. Kjo do të sigurojë që politikat dhe programet të financohen në mënyrë të qëndrueshme, duke shmangur varësinë ekskluzive nga donatorët ndërkombëtarë.
- Do të përforcohet roli monitorues i mekanizmave për të garantuar transparencën dhe efikasitetin e masave të marra dhe adresimin e situatave.
- Do të investohet në trajnimin dhe fuqizimin e kapaciteteve institucionale. Viktimat e dhunës sipas këtij ligji trajtohen vetëm nga profesionistë të trajnuar dhe specializuar në këtë fushë. Autoriteti kryesor përgjegjës bashkëpunon, me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike, Shkollën e Magjistraturës, Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Akademinë e Sigurisë, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, Shkollën e Avokatisë, Urdhrin e Psikologut dhe Urdhrin e Punonjësit Social, Shërbimin e Provës, Përmbarrimin, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, Autoritetin e Mediave Audiovizive, OJF dhe me organizata dhe agjenci të akredituara për të ofruar trajnime për tematika që lidhen me çështje të dhunës ndaj grave dhe dhunës në marrëdhëniet familjare.

Institucionet me detyra trajnuese, në nivel qendror dhe vendor, hartojnë programe tematike dhe kalendarë të trajnimeve për punonjësit sipas fushës së përgjegjësisë të përcaktuar në këtë ligj dhe realizojnë trajnime vazhduese të detyrueshme, të përshtatura sipas nevojave dhe rolit, duke inkurajuar trajtime gjithëpërfshirëse.

Punonjësi i caktuar nga organi kompetent në strukturat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje trajnohet, por pa u kufizuar, lidhur me përgjegjësitë institucionale, adresimin e rastit, rregullat e komunikimit dhe të qëndrimit të viktimës, ndërveprimin institucional, mbi masat mbrojtëse, ato të sigurisë dhe mbështetjen e viktimave. Autoriteti kryesor përgjegjës, udhëzon mbi baza vjetore, mbi temat e domosdoshme të trajnimit nisur nga problemet e evidentuara dhe format e reja të dhunës.

3. Forcimi i mekanizmave në nivel qendror dhe vendor

Për të siguruar progres në parandalimin dhe mbrojtjen ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje nevojitet që situata të matet dhe vlerësohet në mënyrë të vazhdueshme dhe për këtë është e nevojshme që të krijohen dhe forcohen mekanizmat e monitorimit dhe raportimit. Sipas ligjit, Autoriteti kryesor përgjegjës ushtron rol drejtues, koordinues dhe monitorues në bashkërendim me autoritetet dhe subjektet e tjera. Gjithashtu detyrimet monitoruese kanë gjithë autoritetet e tjera përfshi edhe institucionet e tyre të varësisë. Njësitë e vetëqeverisjes vendore ndjekin monitorimin e zbatimit e urdhërave mbrojtës si dhe koordinimit ndër-institucional; Gjithashtu vihet re roli i institucioneve të sistemit të drejtësisë dhe atyre trajnuese.

- Do të përmirësohet mbledhja dhe analizimi i të dhënave: Autoriteti kryesor përgjegjës dhe INSTAT përgatisin të dhëna të disagreguara mbi të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke përfshirë në mënyrë të veçantë rastet e femicidit, me qëllim monitorimin dhe hartimin më efektiv të politikave mbrojtëse dhe parandaluese.

- Çdo pesë (5) vjet, autoriteti kryesor përgjegjës dhe INSTAT-i realizojnë studimin kombëtar të prevalencës së të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Autoriteti kryesor përgjegjës në bashkëpunim me INSTAT-in, mbledh, ruan, përpunon dhe publikon çdo vit të dhënat për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, përfshirë femicidin, në përputhje me ligjin për statistikat zyrtare, legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe metodologjitë e INSTAT-it.

4. Përfshirja e Sektorit Privat dhe Shoqërisë Civile

Dhuna ndaj grave është një problem shqetësues brenda familjes dhe jashtë saj dhe për këtë arsye ligji parashikon angazhim të gjerë të sektorit privat dhe shoqërisë civile. Autoritetet përgjegjëse zhvillojnë dhe promovojnë, në bashkëpunim me aktorët e sektorit privat, institucionet për mbrojtjen e fëmijëve, prindërit dhe edukatorët për mënyrën si të trajtojnë mjedisin e informacionit dhe komunikimit që ofron akses ndaj përmbajtjes së dëmshme dhe degraduese.

- Do të forcohet bashkëpunimi me subjektet publike, private, të medias, partitë politike, profesionet e lira dhe të vetregulluara. Këto subjekte do të hartojnë dhe miratojnë udhëzues, politika dhe procedura kundër dhunës dhe ngacmimit dhe çdo formë tjetër sjelljeje që cenon dinjitetin në botën e punës duke përfshirë raportimin, mekanizmat dhe procedurat e shqyrtimit të çdo kërkesë apo ankimi.

- Do të inkurajohet angazhimi i organizatave të shoqërisë civile.

5. Harmonizimi i Politikave me Integrimin Evropian

Për të përmbushur detyrimet e Shqipërisë në procesin e integritimit në Bashkimin Evropian dhe për të siguruar që parandalimi dhe mbrojtja ndaj dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje të jetë në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, do të ndërmerren masat e mëposhtme:

- Do të vazhdojë harmonizimi i ligjeve shqiptare me standardet e BE-së dhe konventat ndërkombëtare, duke siguruar që ligji i ri të përputhet me direktivat dhe rekomandimet e Komisionit Evropian, CEDAË dhe GREVIO.

- Do të forcohet mekanizmi i raportimit mbi progresin e Shqipërisë në fushën e mbrojtjes nga dhuna, duke siguruar një komunikim të qartë dhe të rregullt me institucionet ndërkombëtare mbi arritjet dhe sfidat në këtë fushë.

- Do të krijohen programe dhe fonde të posaçme për fushata ose programe të rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit të publikut, të financuara nga BE dhe organizatat ndërkombëtare, duke shfrytëzuar mundësitë për tërheqjen e mbështetjes teknike dhe financiare nga partnerët ndërkombëtarë.

Zbatimi i këtyre masave do të garantojë që ligji i ri të jetë me rezultate dhe efektiv. Përmes sigurimit të financimeve të nevojshme, forcimit të kapaciteteve institucionale, edukimit të brezave të rinj, monitorimit të vazhdueshëm dhe përfshirjes së sektorëve kyç, Shqipëria do të krijojë një model të suksesshëm për promovimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje

Faza e shqyrtimit/ vlerësimit

- Jepni një përshkrim të përmblendhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.

- Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e qëllimeve ose progresin drejt tyre.

Autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij ligji është Ministria që mbulon çështjet e barazisë gjinore dhe çështjet sociale. Kjo ministri ushtron rol drejtues, koordinues dhe monitorues në bashkërendim me autoritetet dhe subjektet e tjera. Autoriteti kryesor përgjegjës ushtron funksionin e autoritetit kombëtar për koordinimin dhe bashkërendimin ndërinstitucional dhe mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve nga autoritetet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për krijimin e strukturave të posaçme duke konsideruar parimin e përshtatjes së arsyeshme si dhe zbatimin e programeve trajnuese të detyrueshme bazuar në politikat e miratuara, nevojat sipas sektorëve dhe të dhënave statistikore.

Autoriteti kryesor përgjegjës bashkërendon punën për mbledhjen dhe mbajtjen e të dhënave statistikore nga autoritetet përgjegjëse dhe subjektet publike e private sipas përcaktimeve në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi për statistikat dhe paraqet raportin vjetor pranë komisionit përgjegjës parlamentar/nënkomisionin për çështjet e barazisë gjinore dhe të parandalimit të dhunës ndaj grave.

a. Ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe çështjet sociale

- mbikëqyr përmbushjen e detyrimeve nga autoritetet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor për krijimin e strukturave të posaçme duke konsideruar parimin e përshtatjes së arsyeshme si dhe zbatimin e programeve trajnuese të detyrueshme bazuar në politikat e miratuara, nevojat sipas sektorëve dhe të dhënave statistikore;

- bashkërendon punën për mbledhjen dhe mbajtjen e të dhënave statistikore nga autoritetet përgjegjëse dhe subjektet publike e private.

a. Ministrinë dhe Institucionet Publike

- monitorojnë përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga ky ligj përfshirë edhe institucionet e varësisë; hartimin e akteve si udhëzime/protokolle/procedura në nivel vendor të lidhura me: raportimin, informimin e viktimës, hartimin e planit individual të ndërhyrjes sipas këtij ligji ose ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, përgatitjen e raportit të rastit dhe vënien në dispozicion të viktimës ose shoqëruesit të tij/saj; referimin të shërbimeve mbështetëse dhe mbrojtëse të përgjithshme dhe të specializuara, standardet e mjediseve të posaçme; shoqërimin dhe sigurimin e transportit; veprimet në rastet e shkeljeve të urdhrave të mbrojtjes; materialet e nevojshme informative dhe të përshtatshme; komunikimin me publikun, planifikimeve vjetore për fushata, programe për edukimin ligjor, ndërgjegjësimin, trajnimin dhe çdo masë tjetër të nevojshme.

Gjithashtu, do të kenë rol të rëndësishëm policia e shtetit, gjykatat dhe përmbaruesit gjyqësorë për sa i përket masave të mbrojtjes, Mekanizmi Kombëtar i Referimit, koordinatorët vendorë për referimin e dhunës si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të opsionit të preferuar do të realizohet nga MSHMS në bashkëpunim me INSTAT, përmes mbajtjes, analizimit dhe publikimit të të dhënave vjetore për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, përfshirë femicidin, në përputhje me ligjin për statistikën zyrtare, legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe metodologjitë e INSTAT-it. Autoriteti kryesor përgjegjës MSHMS dhe INSTAT përgatisin të dhëna të disagreguara mbi të gjitha format e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, duke përfshirë në mënyrë të veçantë rastet e femicidit, me qëllim monitorimin dhe hartimin më efektiv të politikave mbrojtëse dhe parandaluese. Çdo pesë (5) vjet, autoriteti kryesor përgjegjës dhe INSTAT-i realizojnë studimin kombëtar të prevalencës së të gjitha formave të dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. Botimi bëhet sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për statistikën zyrtare.

Kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave janë:

Për të vlerësuar ndikimin dhe suksesin e ligjit të ri për dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, është e domosdoshme të përcaktohen kriteret dhe tregues të qartë matës, të cilët do të ndihmojnë në monitorimin e progresit në parandalimin dhe adresimin e problematikave me qëllim identifikimin e problemeve ku nevojiten përmirësime.

1. Përputhshmëria me Standardet Ndërkombëtare dhe BE

- Numri i ligjeve dhe politikave të harmonizuara me direktivat e BE-së dhe konventat ndërkombëtare (CEDAë , Konventa nr. 190 të ONPsë, Rekomandimet e GREVIO, UPR, Raportet e BE-së, etj).
- Përqindja e rekomandimeve ndërkombëtare të zbatuara brenda afateve të përcaktuara.

2. Efektiviteti në parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna

- Numri në rritje i rasteve të grave viktime të dhunës ndaj grave dhe numri i rasteve të viktimave të dhunës në familje të trajtuara nga sistemi i drejtësisë dhe MKR, etj.

3. Forcimi i Institucioneve për Zbatimin e Ligjit

- trajnimi i autoriteteve ligjzbatuese sipas profilit dhe llojit të shërbimeve në nivel qendror dhe vendor;
- mbështetja me buxhete e masave të parashikuara nga ligji.

Tregues matës të trajnimit: numri dhe përqindja e stafit të trajnuar, numri i moduleve të certifikuara, shkalla e bashkive që zbatojnë trajnimet, vlerësimi para/ pas trajnimit, numri i rasteve të trajtuara sipas protokolleve.

Tregues matës financiarë: buxheti i alokuar dhe i shpenzuar, numri i shërbimeve të financuara, pjesëmarrja e bashkive në buxhetimin gjinor, kosto për viktimë, fonde ndërkombëtare të tërhequra.

4. Mbledhja dhe Analiza e të Dhënave për Dhunën ndaj Grave dhe Dhunën në Familje

- Përqindja e numrit në rritje të institucioneve publike dhe private që raportojnë të dhëna për dhunën ndaj grave dhe dhunë në familje, përfshirë femicidin, në mënyrë të rregullt.
- Numri i studimeve dhe raporteve të hartuara.

5. Mbështetja nga Grupet e Interesit

- Numri i organizatave të shoqërisë civile të përfshira në monitorimin dhe zbatimin e ligjit.
- Numri i fushatave të ndërgjegjësimit të zhvilluara në bashkëpunim me sektorin privat dhe OJF-të.

6. Kosto dhe Përfitimet Afatgjata

- Efikasiteti i përdorimit të fondeve të destinuara për parandalimin e dhunës krahasuar me rezultatet e arritura. Efikasiteti i përdorimit të fondeve matet përmes: përqindjes së buxhetit të alokuar dhe të shpenzuar për masat e parandalimit; koston mesatare për viktimë të mbështetur; numrit të shërbimeve të financuara dhe aksesueshmërisë së tyre; uljes së rasteve të përsëritura të dhunës; rritjes së rasteve të identifikuar dhe të menaxhuara sipas protokolleve; si dhe raportit midis burimeve të investuara dhe rezultateve të arritura në parandalim, mbrojtje dhe rehabilitim.

7. Përmbushja e Detyrimeve Ndërkombëtare

- Përmbushja e detyrimeve ndërkombëtare matet përmes: numrit dhe përqindjes së rekomandimeve të BE-së, Konventës së Stambollit, CEDAË dhe mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë që janë zbatuar ose janë në proces zbatimi; shkallës së harmonizimit të legjislationit kombëtar me direktivat dhe standardet ndërkombëtare (p.sh., përqindja e dispozitave të transpozuar); numrit të akteve nënligjore të miratuara brenda afateve të përcaktuara; nivelit të zbatimit të mekanizmave të monitorimit të kërkuar ndërkombëtarisht; dhe përmirësimit vjetor të treguesve kombëtarë mbi parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimave dhe qasjen në drejtësi, të krahasuar me standardet ndërkombëtare referente.

8. Praktikueshmëria dhe Zbatueshmëria

- Numri i sektorëve dhe institucioneve që kanë zbatuar masat konkrete ligjore për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.
- Përqindja e rekomandimeve të dala nga mekanizmat monitorues që janë zbatuar me sukses.

Këta tregues do të ndihmojnë në matjen objektive të përparimit të parandalimit dhe mbrojtjes së viktimave të dhunës duke siguruar një kuadër të qartë për vlerësimin e suksesit të ligjit dhe identifikimin e fushave ku nevojiten ndërhyrje shtesë.

Propozues

**Ministri i Shëndetësisë dhe Mirëqenies
Sociale**

Evis Sala

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin - një herë	126 000	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi	22 700	222 700	322 700	160 000	260 000	160 000	160 000	160 000	160 000	260 000
Kosto për bizneset - një herë										
Kosto për bizneset - në vazhdimësi										

Kosto për grupet e tjera - një herë										
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi										
Kosto në total	148.7	222.7	322.7	160	260	160	160	160	160	260
Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës	148.7	211.6	293.7	139.2	213.2	126.4	120	113.6	108.8	169
Përfitimet për buxhetin – një herë										
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimet për grupet e tjera – një herë										
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi										
Përfitimet për biznesin – një herë										
Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi										
Përfitimet totale	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Përfitimi i zbritur= Përfitimi në total x faktori zbritës										
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total	0									
Vlera prezente aktuale e kostos në total	2 014.1									

Vlera	-	2
Prezente		01
Neto Aktuale		4
(VAN) =		1
Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total		

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsiioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	0	0	0
Opsioni 3	0	0	0
Opsioni 4	2 014. 1	0	2 014. 1